



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25 regjistër (JR)
Datë 25.10.2018

Nr. 13 i vendimit
Datë 20.06.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Luan Daci	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 20.06.2019, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 25, datë 25.10.2018, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bledar Abdullahi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 63 dhe 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 46 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) me vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, ka vendosur:
 - *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, me detyrë gjyqtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.*
 - *Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
 - *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
2. Vendimmarrjen e tij, Komisioni e ka mbështetur në konkluzionet e mëposhtme.

2.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

a) *deklarimi është i pasaktë, për shkak se personat e lidhur, të përmendur në certifikatën familjare, nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklarim në “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit”, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Këta persona duhet të deklaronin saktësisht dhe plotësisht pasuritë;*

b) *në “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit” deklarimi është i pamjaftueshëm, për shkak se burimi i ligjshëm i krijimit nuk është deklaruar, në kundërshtim me detyrimin kushtetues dhe ligjor. Sipas pikës 2 dhe 3 të nenit D të Kushtetutës, subjekti ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar, për të shpjeguar në mënyrë bindëse origjinën e ligjshme të aseteve dhe të të ardhurave dhe, në bazë të paragrafit 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë;*

c) *deklarim i pamjaftueshëm lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën totale prej 2900000 lekësh (për investimet në emër të prindërve), bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;*

ç) *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2008, në bazë të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;*

d) *deklarimi është i pamjaftueshëm në deklaratat e interesave privatë, periodikë/vjetorë, për vitet 2014, 2015, për shkak se bashkëjetuesja nuk ka deklaruar pasuritë, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.”*

2.2 Për kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

2.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është i aftë.

II. Shkaqet e ankimit

3. Kundër vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Bledar Abdullahi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i cili ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë, bazuar në shkaqet e mëposhtme.

A. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

3.1 Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi moskomunikimi i trupit gjykues dhe këshilltarëve të relatores në kohë reale, që në datë 30.11.2017, e ka vënë subjektin në pamundësi objektive për verifikimin dhe shqyrtimin eventual të pretendimit për ekzistencën e konfliktit të interesit me relatorin e çështjes, S. Zhegu, sepse bashkëjetuesja e tij A.O., në cilësinë e noteres, nuk ka pranuar të redaktojë një akt noterial për znj. Zhegu dhe familjarë të afërt të saj; bashkëshorti i relatores është proceduar/gjykuar dhe dënuar disa herë për vepra penale nga gjykata ku subjekti ushtron detyrën, si dhe znj. Zhegu është përfshirë në një procedurë të mëparshme vlerësimi/kontrolli të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, gjatë kohës që ajo ushtronte detyrën e Autoritetit Përgjegjës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Për këto shkaqe të konfliktit të interesit, relatorja e çështjes, bazuar në nenet 30 dhe 31 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të kishte deklaruar kryesisht dorëheqjen.

3.2 Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur, pasi gazeta “Shqiptarja.com” dhe televizioni “A1 Report”, nëpërmjet fushatës së shpifjeve ndaj subjektit dhe personit të lidhur me të, janë kthyer në zëdhënës zyrtarë të Komisionit, duke i krijuar subjektit bindjen se ndikimi i tyre në trupin gjykues ka qenë i drejtpërdrejtë. Shifrat që këto media referonin për pasuritë e prindërve të tij dhe bashkëjetueses së tij, ishin absurde dhe nuk përputheshin me realitetin e fakteve. Administrimi nga Komisioni i denoncimit të një të vdekuri, si dhe i denoncimeve të bankës “Raiffeisen” në kushtet e konfliktit të interesit, kur ky institucion është në marrëdhënie financiare me Komisionin dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, është tregues i një procesi të paragjykuar. Gjithashtu, përbërja e trupit gjykues nuk përmbush kriteret ligjore dhe kushtetuese për t’u zgjedhur anëtarë të Komisionit.

3.3 Komisioni ka shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi procesi i rivlerësimit për subjektin ka përfunduar pas 1 viti e 6 muajsh nga data e shprehjes së interesit të tij për të kandiduar për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në kundërshtim me nenin 276, pika 4 e ligjit nr. 115/2016, ndërsa vendimi nr. 51, datë 30.07.2018, i është njoftuar rreth dy muaj më vonë nga data e shpalljes së tij, në kundërshtim me afatin ligjor, si dhe nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar dhe as është lejuar të këqyrë dosjen e tij për efekt të ushtrimit të së drejtës së ankimit.

3.4 Komisioni nuk i ka dhënë subjektit mundësinë reale për ushtrimin e barrës së provës, duke i mohuar të drejtën e realizimit efektiv të mbrojtjes dhe barazisë së armëve, pasi nuk iu ngarkua barra e provës lidhur me faktin e bashkëjetesës; nuk iu pranua asnjë nga 27 provat e kërkuara/depozituara në funksion të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ; në kundërshtim me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe Kodin e Procedurave Administrative nuk i janë bërë të njohura provat e administruara, provat që nuk janë marrë në konsideratë, si dhe rezultati i pritshëm i mundshëm, madje iu kërkua të paraqiste shpjegimet brenda një kohe shumë të shkurtër, 4-ditore, nga data e caktimit të seancës dëgjimore.

3.5 Komisioni i ka mohuar subjektit të drejtën kushtetuese për t’u dëgjuar/gjykuar drejtësisht, pasi nuk u kujdes kryesisht për zhvillimin e seancës dëgjimore me dyer të mbyllura, sipas neneve 58/a, 103, 104 dhe 340 të Kodit të Procedurës Penale, duke shkelur nenin 8 të KEDNj-së, kur në të do të diskutohej jeta private e bashkëjetueses së tij dhe e familjarëve të saj; nuk ka analizuar fakte dhe rrethana me rëndësi për çështjen, si dhe ka fshehur e manipuluar fakte me pasojë shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor.

3.6 Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit ka qenë dukshëm i paragjykuar dhe vendimmarrja e paracaktuar, pasi vendimi i Komisionit është marrë pa vlerësimin dhe analizën e duhur të provave, për pasojë ky vendim është i paarsyetuar, kontradiktor, me gabime materiale, me shprehje denigruese e cinike.

3.7 Vendimi i Komisionit është në shkelje të hapur të parimeve të mosdënimit pa ligj dhe mospërgjegjësisë pa faj.

3.8 Komisioni ka shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, si dhe parimin e ushtrimit të së drejtës për t'u dëgjuar, pasi referuar rezultateve të hetimit administrativ, subjektit nuk i ka kaluar barra e provës për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, ndërkohë që në seancën dëgjimore të datës 26.07.2018, relatorja e çështjes në mënyrë të papritur ngriti si problematikë “zvarritje procesi në një çështje civile” apo “ndryshimin e vendimit të një mase sigurimi nga Gjykata e Apelit”.

3.9 Subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e tij, duke riçelur/përsëritur hetimin gjyqësor me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, pasi hetimi administrativ dhe gjyqësor i Komisionit është i pavlefshëm, për shkak të shkeljeve procedurale të cituara në shkaqet e mësipërme të ankimit.

B. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

3.10 Komisioni, duke analizuar dhe konkluduar rreth një marrëdhënieje personale me karakter pasuror siç është bashkëjetesa, mbi fshehjen nga subjekti i rivlerësimit të kësaj marrëdhënieje me znj. A.O. që në vitin 2004, ndërkohë që subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se bashkëjetesën e ka filluar në vitin 2012, ka shkelur parimet e shtetit të së drejtës, në tejkallim të kompetencave dhe juridiksionit që i njuh Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 dhe njëherësh ka shkelur të drejtat mbi jetën private dhe të drejtën e familjes së subjektit të rivlerësimit.

3.11 Në konkluzionin se bashkëjetuesja e subjektit, znj. A.O., ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, Komisioni ka kryer një analizë financiare të padrejtë, e cila nuk pasqyron në mënyrë korrekte të ardhurat e saj. Komisioni, në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencë, ka anashkaluar vlerësimin dhe analizimin e dy dokumenteve shkencore, siç janë raportet e veçanta të audituesit ligjor, depozituar nga subjekti në datat 22.06.2018 dhe 04.07.2018.

3.12 Në vlerësimin e burimeve financiare të ligjshme të znj. A.O., Komisioni nuk ka marrë në konsideratë, në mënyrë të padrejtë, të ardhurat e personave të saj të lidhur brenda trungut familjar. Konkluzioni i Komisionit për mungesën e aftësisë paguese të prindërve të znj. A.O. është haptazi i pabazuar dhe në shkelje flagrante të ligjit, pasi nuk ka marrë në konsideratë ekzistencën dhe gjendjen e llogarive bankare të personave të lidhur të znj. A.O., të cilat datojnë që para vitit 2000, kohë kur subjekti i rivlerësimit ishte ende student.

3.13 Komisioni ka arritur në përfundimin se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, duke mos marrë në konsideratë, në mënyrë të padrejtë, të ardhurat e personave të trungut të subjektit të rivlerësimit (prindërve dhe vëllait të tij), të cilat për shkak të lindjes së fëmijës së subjektit të rivlerësimit nuk ka asnjë pengesë që të përfshihen në të ardhurat e znj. A.O..

3.14 Në analizën financiare, në kundërshtim me provat e administruara, Komisioni ka ekzagjeruar padrejtësisht shpenzimet e jetesës për znj. A.O., duke mos marrë në konsideratë faktin se ajo ka jetuar me familjarët e trungut të origjinës dhe ka pasur ndihmë financiare nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prindit të fëmijës, si dhe prindërit e tij në cilësinë e gjyshërve. Analiza financiare është jotransparente dhe jologjike, pasi në vendim nuk jepet asnjë informacion mbi metodologjinë e përdorur në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, si dhe ato janë ekzagjeruar, në një kohë kur standardi i jetesës para vitit 2008 ka qenë i ulët. Analiza financiare nuk është e saktë, pasi në vendim është llogaritur shuma 5.066.650 lekë si shpenzime jetese për znj. A.O., ndërsa në rezultatet e hetimit administrativ i është llogaritur një shumë më e vogël, në vlerën 3.186.193 lekë.

3.15 Në kundërshtim me provat e administruara, në analizën financiare të Komisionit, në shpenzimet e udhëtimit, znj. A.O. i janë llogaritur shpenzime për udhëtime që ajo i ka kryer për shkak të punës, si dhe shpenzime për udhëtimet private, por që i janë paguar nga familjarët e vet. Analiza financiare nuk është e saktë, pasi në vendim është llogaritur shuma 815.797 lekë si shpenzime udhëtimi për znj. A.O., ndërsa në rezultatet e hetimit administrativ i është llogaritur një shumë më e vogël, në vlerën 530.768 lekë.

3.16 Analiza financiare e Komisionit, padrejtësisht, ndalet te pika e shumës së derdhur prej 131.500 eurosh deri në datë 26.09.2008, duke bërë kështu copëzimin e hetimit lidhur me vlerësimin e pasurisë së personit të lidhur, në një kohë kur znj. A.O. nuk ishte subjekt deklarimi dhe marrëdhënia kontraktore ishte ende e pafinalizuar e për më tepër kur pranohet nga znj. A.O. se në atë periudhë ajo nuk ishte pronarja e vetme e shumës së derdhur, pasi derdhje të shumës për llogari të vet ka bërë dhe babai i saj. Analiza financiare e Komisionit duhet të ishte shtrirë deri në vitin 2013, vit në të cilin është materializuar kontrata e shitjes, me qëllim përcaktimin objektiv dhe real të vlerës në total të pasurisë, ashtu siç është vepruar për subjekte të tjera rivlerësimi, për të cilët hetimi është zhvilluar i plotë dhe i shtrirë për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

3.17 Komisioni i ka lejuar vetes cenimin e parimit të proporcionalitetit, pasi nuk ka marrë në konsideratë faktin e provuar nga hetimi se subjekti i rivlerësimit e familjarët e tij dhe personi i lidhur e familjarët e tij kanë bërë një jete modeste. Komisioni, në kundërshtim me parimin e vlerësimit tërësor të procedurave, ka injoruar faktin se znj. A.O. në marrëdhëniet e saj kontraktore ka respektuar kërkesat e legjislacionit në shkallën më të lartë, pavarësisht se viti 2007 ka qenë një periudhë informaliteti.

3.18 Komisioni, përkundër parimit kushtetues, frymës së ligjit nr. 84/2016 për mosngarkimin me barrën e provës në rastin kur subjekti i rivlerësimit nuk ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka injoruar faktin se vetëm të ardhurat personale të znj. A.O. janë në masën 23.690.911 lekë, ndërsa vlera e pasurisë së saj është 16.327.900 lekë. Në këtë mënyrë, Komisioni ka rënë ndesh me vlerësimin e bërë nga institucioni i specializuar ILDKPKI, me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në çështjen për subjektin e rivlerësimit F. L., si dhe ka cenuar nenet 4 dhe 13 të Kodit të Procedurave Administrative.

3.19 Konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për shkak se personat e lidhur, të përmendur në certifikatën e tij familjare, nuk kanë përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor për deklarim, nuk përbën provë të mjaftueshme, pasi kjo rrethanë ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit ligjor nga ILDKPKI-ja; dokumentacioni ekziston dhe është depozituar në një institucion legjitim si Kuvendi i Shqipërisë, si dhe në rastin konkret bëhet fjalë për persona jo në ngarkim, për pasojë detyrimi për deklarim nuk qëndron.

Subjekti kërkon të thirret si dëshmitare specialistja e ILDKPKI-së, znj. E.D., e cila ka refuzuar të administrojë deklaratat e pasurisë së personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

3.20 Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë së personave të lidhur nuk qëndron, pasi vërehet lehtësisht se ekzistenca e llogarive bankare të fondeve të investimit të prindërve të subjektit është konstatuar nga vetë ILDKPKI-ja; nuk rezulton të jenë konsumuar elementet objektive dhe subjektive të fshehjes së pasurisë sipas nenit 257/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal, as nga subjekti, as nga personat e lidhur me të, si dhe provohet me dokumentacion bankar se krijimi i fondit të investimit ka burim të ligjshëm, sikundër janë pagat e personave të lidhur.

3.21 Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën 2.900.000 lekë (për investimet në emër të prindërve) nuk qëndron, pasi ligji nr. 84/2016 nuk njeh “pamjaftueshmëri në mosdeklarim”. Gjatë gjithë hetimit, Komisioni i ka ngarkuar subjektin të rivlerësimit barrën e provës për situatën ligjore të “fshehjes së pasurisë”, ndërsa në vendim çuditërisht është argumentuar për fshehje pasurie, por është konkluduar për pamjaftueshmëri të mosdeklarimit të likuiditeteve.

3.22 Konkluzioni i Komisionit se bashkëjetuesja e tij nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklaram për vitet 2014 dhe 2015 nuk qëndron, pasi bashkëjetuesja ka nënshkruar rregullisht “Autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave”, por nga ana e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nuk është kërkuar për këtë periudhë “Kryerja e deklaramit me kërkesë”. Mungesa e reagimit të institucionit përgjegjës ILDKPKI, i cili kishte detyrimin të kërkonte rregullsinë e plotësisht të deklaratës dhe anekseve të saj, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Qëndrimi interpretues i ILDKPKI-së gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, është një akt i pavlefshëm, pasi është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij, referuar nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative. Znj. A.O. nuk ka kryer asnjë veprim me qëllim tjetërsimin e pasurive të saj të paluajtshme, që nga momenti që i ka lindur detyrimi për deklaram, çka do të thotë se moshoqërimi i “Autorizimit” me deklaratën e pasurisë nuk ka sjellë asnjë pasojë. Objekti i kontrollit nga institucionet e rivlerësimit duhet të ishte vetëm deklaramata e pasurisë së rivlerësimit dhe jo deklaramet e bëra në vite nga subjekti i rivlerësimit. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive nga znj. A.O. në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit është një pasaktësi e paqëllimshme.

III. Rrethanat e çështjes

4. Subjekti i rivlerësimit Bledar Abdullahi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 276 të ligjit nr. 115/20161 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ishte kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin Bledar Abdullahi, bazuar në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga organet ligjzbatuese, sipas të cilave:

4.1 Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- o *Deklarami është i saktë në përputhje me ligjin.*
- o *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*

- o *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
- o *Nuk ka kryer deklarin të rremë.*
- o *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konkluduar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi.*

4.3 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer analizën e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, duke konstatuar kryesisht probleme që kanë të bëjnë me shkelje të afateve në gjykimin e çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ka informuar mbi një ankesë të vitit 2014, për zvarritje dhe mosrespektim formal të ligjit, prej së cilës gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim.

5. Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Inspektorati i KLD-së, kreu procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, Komisioni, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bledar Abdullahi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

6. Në shqyrtim dhe vlerësim të procedurës administrative të ndjekur gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues”) arsyeton si më poshtë.
7. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi moskomunikimi i trupit gjykues dhe këshilltarëve të relatores në kohë reale, që në datë 30.11.2017, e ka vënë në pamundësi objektive për verifikimin dhe shqyrtimin eventual të pretendimit për ekzistencën e konfliktit të interesit me relatorin e çështjes S. Zhegu, sepse bashkëjetuesja e tij, znj. A.O., në cilësinë e noteres, nuk ka pranuar të redaktojë një akt noterial për znj. Zhegu dhe familjarë të afërt të saj; bashkëshorti i relatorit është proceduar/gjykuar dhe dënua disa herë për vepra penale nga gjykata ku subjekti ushtron detyrën, si dhe znj. Zhegu është përfshirë në një procedurë të mëparshme vlerësimi/kontrolli të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, gjatë kohës që ajo ushtronte detyrën e Autoritetit Përgjegjës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Për këto shkaqe të konfliktit të interesit, relatorja e çështjes, bazuar në nenet 30 dhe 31 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të kishte deklaruar kryesisht dorëheqjen. Trupi gjykues konstaton se referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit nr. 1, datë 14.12.2017, në*

datën 30.11.2017 është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues që do të shqyrtonte procesin e rivlerësimit për subjektin Bledar Abdullahi, i cili përbëhej nga Suela Zhegu (relatore), Genta Tafa (Bungo) (kryesuese) dhe Pamela Qirko (anëtare). Në pikën 2 të tij, ky vendim përcakton: *Të gjithë anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk kanë konflikt interesi me asnjë nga subjektet e rivlerësimit që janë shortuar për trupin gjykues, ku ata bëjnë pjesë.* Bashkëlidhur vendimit të sipërcituar gjendet akti “Deklaratë për konfliktin e interesit”, i nënshkruar nga secili prej anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit. Nëpërmjet postës elektronike, me *e-mail*-in e datës 30.05.2018, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit përbërjen e trupit gjykues dhe të drejtën e tij për të deklaruar konfliktin e interesit. Rezulton se në deklaratat e bëra pas kësaj date, subjekti nuk është shprehur për ndonjë konflikt të mundshëm interesi me secilin prej anëtarëve të trupit gjykues. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 06.07.2018 ka vendosur të njoftojë subjektin për përbërjen e trupit gjykues, për rezultatet e hetimit administrativ, për njohjen me provat e administruara etj., si dhe mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit¹, vendim i cili i është bërë i njohur subjektit, nëpërmjet postës elektronike. Subjekti, më datë 18.07.2018, pra rreth dy javë më vonë, ka paraqitur shpjegimet lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, në përmbajtjen e të cilave nuk ka shprehur asnjë pretendim për konflikt interesi me relatoren e çështjes. Nga verifikimi i procesverbalit të seancave dëgjimore të Komisionit, të zhvilluara në datat 26.07.2018 dhe 30.07.2018, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur ndonjë pretendim apo kundërshtim për përbërjen e trupit gjykues.

8. Subjekti pretendon se për faktet e parashtruara në ankim si shkaqe të ekzistencës së konfliktit të interesit, sipas nenit 30, shkronja “g” e Kodit të Procedurave Administrative, është vënë në dijeni pas zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision, në datë 26.07.2018. Ai është vënë në dijeni nga bashkëjetuesja e tij znj. A.O., se në cilësinë e noteres, ajo nuk ka pranuar të redaktojë një akt noterial për znj. Zhegu dhe familjarë të afërt të saj. Ky fakt, znj. A.O., siç pranon vetë subjekti, i ka ardhur në kujtesë vetëm pasi u njoh fizikisht me relatoren S. Zhegu. Ndërsa për faktin se bashkëshorti i relatores është proceduar/gjykuar dhe dënuar disa herë për vepra penale nga gjykata ku subjekti ushtron detyrën dhe se vetë relatorja është palë në disa procese gjyqësore pranë kësaj gjykate, ai është vënë në dijeni nga kolegët, pas zhvillimit të seancës dëgjimore datë 26.07.2018. Gjithashtu, znj. Zhegu është përfshirë në një procedurë të mëparshme vlerësimi/kontrolli të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, gjatë kohës që ajo ushtronte detyrën e Autoritetit Përgjegjës në KLD, që është i njëjti objekt veprimtarie me detyrën që ajo ushtron si komisionere.
9. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ligji nr. 84/2016, në nenin 27 të tij, garanton të drejtat e palëve për një proces të paanshëm, duke parashikuar mundësinë e përjashtimit të një anëtari të trupit gjykues, kur ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie sipas nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Në asnjë nen të bazës ligjore të sipërpërmendur nuk parashikohet një afat i posaçëm, për komunikimin e përbërjes së trupit gjykues të subjektit i rivlerësimit. Në këtë kuptim, fakti që Komisioni ia ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit trupin gjykues, në datë 30.05.2018 nëpërmjet postës elektronike, në datë 06.07.2018 në përfundim të procedurës hetimore dhe përsëri në seancën dëgjimore më datë 26.07.2018, përbën përmbushjen e detyrimit ligjor për t’i garantuar subjektit të drejtën për të ngritur çdo pretendim në raport me shkeljen e parimit të paanësisë në procesin e rivlerësimit, pretendime që subjekti nuk i ka ngritur në asnjë moment të procesit, por i ngre vetëm në ankimin e tij. Nga sa parashtron vetë subjekti, verifikimi i pretendimeve të tij nuk varej nga momenti i

¹ Pika 4 e vendimit nr. 02, datë 06.07.2018, të trupit gjykues të Komisionit.

komunikimit të përbërjes së trupit gjykues, pasi bashkëjetueses së tij iu desh njohja fizikisht me znj. Zhegu për t'i ardhur në kujtesë faktet e cituara më sipër, ndërsa vetë ai u njoh me faktet e ekzistencës së vendimeve penale ndaj bashkëshortit të znj. Zhegu, vetëm pasi kolegët e tij u njohën me trupin gjykues që do ta vlerësonte atë. Ndërsa, për faktin që relatorja e çështjes është përfshirë në një procedurë të mëparshme vlerësimi/kontrolli të pasurisë së tij, gjatë kohës që ajo ushtronte detyrën e Autoritetit Përgjegjës në KLD, subjekti ka qenë në dijeni të plotë, sepse gjatë procesit të rivlerësimit në Komision ka qenë ai që ka paraqitur në cilësinë e provës komunikimin shkresor të KLD-së me të, në vitin 2014.

10. Në argumentimin e situatës së konfliktit të interesit për faktet e sipërcituara, subjekti bazohet në parashikimin e nenit 30, shkronja “g” e Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton: *Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur:[...] g) nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b” të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim”.*
11. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se faktet e deklaruara nga subjekti nuk përbëjnë shkaqe serioze njëanshmërie, pasi fakti i moskryerjes së një veprimi noterial nga bashkëjetuesja e subjektit në favor të znj. Zhegu nuk mund të konsiderohet marrëdhënie në kuptim të normës së cituar më sipër. Refuzimi i kryerjes së veprimit noterial nga znj. A.O. ka qenë një veprim në ushtrim të funksionit të saj si noter publik, brenda sferës profesionale të ushtrimit të funksionit, në interpretim dhe zbatim të legjislacionit të kohës. Në këtë kuptim, veprimet e kryera prej saj në ushtrim të detyrës, nuk mund të përbëjnë shkak njëanshmërie për personat ndaj të cilëve është refuzuar veprimi. Në këndvështrim të parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, trupi gjykues vëren se në nenin 3, pika 1, ky ligj përkufizon konfliktin e interesit si gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. Ndërsa neni 5, pika 1, shkronja “dh” e të njëjtit ligj, si interesa privatë të zyrtarit përkufizon ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: “dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”. Trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e komisioneres Zhegu me znj. A.O. nuk provohet të ketë qenë një marrëdhënie armiqësie në kuptim të nenit të sipërcituar, vetëm për faktin e pretenduar nga subjekti se znj. A.O. nuk ka pranuar të kryejë një veprim noterial në favor të znj. Zhegu. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë të dhënë tjetër që të tregojë se marrëdhënia mes tyre ka pasur një natyrë armiqësie në kuptim të ligjit, të aftë që të arrinte të ndikonte vullnetin e komisioneres në shqyrtimin e çështjes. Edhe lidhur me proceset gjyqësore të znj. Zhegu apo bashkëshortit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti ushtron detyrën, trupi gjykues vlerëson se ato nuk mund të konsiderohen marrëdhënie të tilla për arsye serioze njëanshmërie, pasi subjekti i rivlerësimit nuk pretendon dhe as provon se ka qenë ai, gjyqtari që ka gjykuar çështjet në fjalë.
12. Trupi gjykues konstaton se subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka provuar se me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2014, Autoriteti Përgjegjës në KLD, e ka njoftuar se ILDKPKI-ja ka konstatuar mangësi në plotësimin prej tij të deklaratës së interesave privatë periodikë. Kjo shkresë është nënshkruar nga znj. Zhegu, e cila ka qenë përfaqësuese e autoritetit përgjegjës në KLD, sipas nenit 41 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin

e funksioneve publike”, të ndryshuar. Trupi gjykues vlerëson se bazuar në nenin 42, pika 3 e ligjit të sipërcituar, Autoriteti Përgjegjës pranë çdo institucioni shtetëror mbledh dhe i dërgon Inspektoratit të Lartë deklaratat e plotësuara të interesave privatë, brenda afatit ligjor për dorëzimin e këtyre deklaratave nga zyrtarët. Autoriteti përgjegjës njofton ILDKPKI-në për rastet e mosdeklarimeve. Ky autoritet kryen detyrat e ngarkuara nga Inspektori i Përgjithshëm për lehtësimin dhe zhvillimin e frytshëm të procesit të deklarimit periodik të interesave, si dhe rasteve të konfliktit të interesave. Ndërsa sipas nenit 11 të po këtij ligji, organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së. Pra znj. Zhegu, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, nuk ka marrë pjesë në një procedurë vlerësimi për kontrollin e pasurisë së subjektit dhe as ka qenë pjesë e ndonjë vendimmarrjeje me këtë objekt.

13. Në lidhje me pretendimin e subjektit se atij nuk i është bërë e ditur përbërja e stafit ndihmës, sikundër janë këshilltari ligjor, këshilltari ekonomik apo dhe këshilltari pranë vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk ka detyrimin për t’i bërë të njohur subjektit këshilltarët ligjorë apo ekonomikë, pasi bazuar në nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016, ata janë nëpunës që ndihmojnë trupin gjykues në studimin dhe përgatitjen e çështjes, por nuk kanë asnjë kompetencë vendimmarrëse gjatë procesit të rivlerësimit.
14. Trupi gjykues arrin në përfundimin se faktet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit nuk hyjnë në sferën e asnjërit prej rasteve të parashikuara dhe identifikuara nga neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative si pengesa ligjore, që të detyronin relatorin Zhegu për të deklaruar dorëheqjen nga procesi i rivlerësimit për këtë subjekt rivlerësimi.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, është i pabazuar.

15. *Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur, pasi gazeta “Shqiptarja.com” dhe televizioni “Al Report” nëpërmjet fushatës së shpifjeve ndaj tij dhe personit të lidhur me të janë kthyer në zëdhënës zyrtarë të Komisionit, duke i krijuar subjektit bindjen se ndikimi i tyre në trupin gjykues ka qenë i drejtpërdrejtë. Shifrat që këto media referonin për pasuritë e prindërve të tij dhe bashkëjetueses së tij ishin absurde e nuk përputheshin me realitetin e fakteve. Administrimi nga Komisioni i denoncimit të një të vdekuri, si dhe i denoncimeve të bankës “Raiffeisen” në kushtet e konfliktit të interesit, kur ky institucion është në marrëdhënie financiare me Komisionin dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, është tregues i një procesi të paragjykuar. Gjithashtu, përbërja e trupit gjykues nuk përmbush kriteret ligjore dhe kushtetuese për t’u zgjedhur anëtarë të Komisionit. Trupi gjykues i Kolegjit, nga tërësia e dokumentacionit të administruar në Komision dhe të shqyrtuar në Kolegj gjatë gjykimit, konstaton se këto pretendime, subjekti nuk i ka ngritur në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit në Komision. Trupi gjykues vëren se jurisprudenca e GjEDNj-së mbështet qëndrimin se një gjyqtar prezumohet i lirë nga çdo anshmëri dhe e kalon barrën e provës në këtë rast te kundërshtuesi i prezumimit; çdo gjyqtar është i paanshëm, derisa të provohet e kundërta. Lidhur me paanësinë objektive, GjEDNj është shprehur në shumë raste se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete, nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor.² Ndërsa në çështjen Craxi kundër Italisë, 2003, GjEDNj është shprehur: *Në një kuptim të përgjithshëm, gjyqtarët nuk mund**

² *Shih Vendimin Hausschildt kundër Danimarkës, datë 24.05.1989; Vendimin Fey kundër Austrisë, datë 24.02.1993, Vendimin Gautrin e të tjerë kundër Francës, datë 20.05.1998.*

të funksionojnë në një vakum: megjithëse ata kanë në kompetencë të vendosin mbi fajësinë ose pafajësinë e një të akuzuari, nuk rrjedh nga kjo që, çështjet për të cilat ata janë vënë në dijeni, nuk mund të diskutohen, qoftë në revista të specializuara, në shtypin kryesor ose në publik. Me kusht që të mos tejkalojnë kufijtë e caktuar për një administrim të mirë të drejtësisë, publiciteti i raporteve të procedurave gjyqësore, duke përfshirë dhe komentet e palëve, janë të pajtueshme me nevojën e publicitetit për seancën gjyqësore, përcaktuar në nenin 6/1 të Konventës. Funksionit të medias, që konsiston në komunikimin e këtyre informacioneve, i shtohet e drejta e publikut për t'i marrë këto informacione. Kjo është edhe më e vërtetë kur procesi, siç është rasti në fjalë, është për një person të njohur, një ish-kryeministër. Këta njerëz, në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije, ekspozohen ndaj një kontrolli të vëmendshëm, si nga gazetarët, ashtu edhe nga masa e qytetarëve. [...] Është e paevitueshme në një shoqëri demokratike, që shtypi, në disa raste të bëjë komente të ashpra mbi një çështje të ndjeshme si kjo në fjalë, e cila vë në pikëpyetje etikën e funksionarëve të lartë publikë dhe raportet mes botës politike dhe asaj të biznesit. Nën dritën e kësaj jurisprudence, trupi gjykues çmon se, bazuar në nenin 179/b, pika 6 e Kushtetutës dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ushtron funksionet si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Komisioni vendos bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në Komision, rezulton se shifrat e përmendura nga mediat e cituara nga subjekti, nuk kanë asnjë lidhje me shifrat e përmendura në aktet procedurale apo vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit. Interesi i medias për procesin e rivlerësimit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, nën dritën e jurisprudence së GjEDNj, por edhe vetë qëllimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, është më se i kuptueshëm. Për sa i përket pretendimit se këto media kanë luajtur rolin e “zëdhënësit” të Komisionit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë, që në mënyrë objektive të vërtetojë se Komisioni ka “furnizuar” mediat në fjalë me të dhëna për subjektin e sidomos në kushtet kur deklaratat e pasurisë të subjekteve të rivlerësimit në vite, janë publike dhe të aksesueshme, qoftë nga mediat, qoftë nga publiku. Trupi gjykues çmon se interpretimi i tyre nga mediat nuk është në përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore, aq më tepër të Komisionit, ndërsa pretendimet e subjektit për shpifje të mediave ndaj figurës së tij apo personit të lidhur, si dhe pasojave të ardhura të familjarët e tij nga këto fushata mediatike, janë çështje që nuk lidhen me procesin e rivlerësimit, për pasojë nuk janë objekt shqyrtimi i trupit gjykues të Kolegjit.

16. Në lidhje me pretendimin e subjektit se administrimi prej Komisionit i denoncimeve të bankës “Raiffeisen”, në kushtet e konfliktit të interesit dhe i denoncimit të një të vdekuri është tregues i një procesi të paragjykuar, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, është shprehur se pranë tij janë paraqitur nëntë denoncime nga publiku, për të cilat pas verifikimit rezultoi se nuk ka indicie për të provuar pretendimet e denoncuesve. Për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke mos e ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore për denoncimet e mbërritura në adresë të tij.
17. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vlerësimi prej një trupi gjykues me nivel arsimor dhe profesional dukshëm nën nivelin e tij dhe në kushtet kur përbërja e këtij trupi nuk përmbush kriteret ligjore dhe kushtetuese për t’u zgjedhur anëtarë, përbën shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues vlerëson se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka kompetencë për të verifikuar kriteret ligjore dhe kushtetuese të emërimit në detyrë të një anëtar të institucioneve të rivlerësimit. ***Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i papabuar.***

18. *Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi procesi i rivlerësimit për të ka përfunduar pas 1 viti e 6 muajsh, nga data e shprehjes së interesit të tij për të kandiduar për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në kundërshtim me nenin 276, pika 4 e ligjit nr. 115/2016, ndërsa vendimi nr. 51, datë 30.07.2018, i është njoftuar rreth dy muaj më vonë nga data e shpalljes së tij, në kundërshtim me afatin ligjor, si dhe nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar dhe as është lejuar të këqyrë dosjen e tij për efekt të ushtrimit të së drejtës së ankimit.* Trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në Komision, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka shprehur interesin për të kandiduar për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, më datë 16.01.2017. Bazuar në nenin 276, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, trupi gjykues arsyeton se procesi i rivlerësimit për këtë subjekt do të duhej të përfundonte brenda muajit prill 2017. Por, organet e rivlerësimit janë krijuar dhe funksionojnë bazuar në ligjin nr. 84/2016, i cili ka hyrë në fuqi, përfundimisht më datë 19.01.2017. Lista e anëtarëve të organeve të rivlerësimit u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” më datë 17.06.2017, ndërsa struktura dhe organika e personelit të Komisionit është miratuar me vendimin nr. 93/2017 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, më datë 29.09.2017. Pas fillimit të funksionimit të tij si organ, Komisioni shortoi gjyqtarin Bledar Abdullahi si subjekt, me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me nenin 267, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 dhe nenin 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Mbledhja e parë e trupit gjykues të Komisionit që ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin është zhvilluar më datë 14.12.2017, duke përcaktuar kështu datën e fillimit të procedurës së rivlerësimit nga Komisioni. Subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, për shkak të pozicionit të tij si gjyqtar, ndërsa kryerja e këtij procesi me prioritet është bërë për shkak të kandidimit të tij për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ligji nr. 84/2016 nuk përcakton afate për kryerjen e procesit të rivlerësimit, por në nenin 4, pika 3 përcakton: “Kur çështja është gati për t’u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm.” Procesi i rivlerësimit për subjektin ka përfunduar me shpalljen e vendimit përfundimtar më datë 30.07.2018, pra brenda 7 muajsh, duke konsideruar që pyetëtori i parë i është drejtuar subjektit nga Komisioni, më datë 22.12.2017. Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se procesi i rivlerësimit për këtë subjekt, është kryer brenda një afati të arsyeshëm.
19. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi i është njoftuar me dy muaj vonesë nga data e shpalljes së tij, trupi gjykues, nga aktet procedurale të Komisionit konstaton se ky i fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 28.09.2018, i ka njoftuar subjektit vendimin nr. 51, datë 30.07.2018 dhe ai e ka marrë njoftimin më datë 02.10.2018. Subjekti, më datë 12.10.2018, ka paraqitur në Komision ankimin kundër vendimit nr. 51, datë 30.07.2018 dhe Komisioni me vendimin nr. 51/1, datë 16.10.2018 e ka pranuar ankimin, i cili u shqyrtua nga trupi gjykues i Kolegjit. Subjekti në pretendimin e tij se njoftimi me vonesë i vendimit ka përbërë shkelje të procesit të rregullt ligjor, nuk ka shpjeguar se cili nga elementet e këtij parimi është shkelur dhe cila është pasoja e ardhur nga kjo shkelje. Trupi gjykues, në referim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 63, pika 1 e po këtij ligji, vlerëson se subjekti legjitimohet të ushtrojë të drejtën e ankimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Duke konsideruar përmbajtjen e dispozitave të sipërcituara, në përputhje me situatën faktike, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk është prekur në të drejtat e tij për ushtrimin e ankimit, për pasojë nuk ka shkelje të parimit të procesit të rregullt.

20. Në lidhje me pretendimin e subjektit se pavarësisht kërkesës së bërë prej tij për vënien në dispozicion të akteve të dosjes përfundimtare për shkak të ushtrimit të së drejtës së ankimit, nga Komisioni nuk iu kthye asnjë përgjigje, madje as nuk u lejua të bëjë këqyrjen e dosjes, trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në Komision, konstaton se subjekti i ka drejtuar Komisionit kërkesë për dorëzim aktesh, protokolluar me nr. {***}, datë 03.10.2018, me të cilën ka kërkuar t'i vihen në dispozicion kopje të të gjithë praktikës që i përket hetimit administrativ të dosjes së tij, si dhe një sërë aktesh të tjera. Komisioni, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 08.10.2018, me lëndë “Kthim përgjigjeje” i ka vënë në dispozicion subjektit dokumentacionin e kërkuar prej tij, me përjashtim të rregulloreve të brendshme të Komisionit, për të cilat e ka informuar se mund t'i shkarkojë nga faqja zyrtare në internet, si dhe të akteve të praktikës së hetimit administrativ, për të cilat i ka sjellë në vëmendje se i ka dhënë më parë kopje fizike dhe elektronike. Më datë 15.10.2018, subjekti i drejtohet përsëri Komisionit me kërkesën me nr. {***} prot., datë 15.10.2018, në të cilën kërkon këqyrjen e të gjithë fashikullit të gjykimit që do t'i dërgohet Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në ushtrim të së drejtës së tij kushtetuese të ankimit. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.10.2018, e informon subjektin se kërkesa e tij për këqyrjen e materialit të fashikullit të gjykimit, pasi ai është njohur paraprakisht e ka tërhequr kopje, si dhe pasi ka ushtruar të drejtën e ankimit, nuk është e bazuar në ligj. Subjekti, më datë 10.07.2018 ka nënshkruar një deklaratë, në të cilën konfirmon marrjen e dosjes së hetimit administrativ në kopje digjitale, ndërsa më datë 12.07.2018 Komisioni nëpërmjet postës elektronike e informonte se ai mund të paraqitet për tërhequr dosjen e tij të procesit të rivlerësimit të fotokopjuar. Në seancën dëgjimore të datës 26.07.2018, subjekti ka konfirmuar se materialet e dosjes së rivlerësimit i janë vënë në dispozicion fizikisht dhe elektronikisht. Më datë 12.10.2018, subjekti ka paraqitur ankimin kundër vendimit nr. 51, datë 30.07.2018. Nga faktet e përshkruara më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti, bazuar në nenin 45 të Kodit të Procedurave Administrative, është njohur me aktet e dosjes së procesit të rivlerësimit, për pasojë nuk ka shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, në datat 14, 15 dhe 20 nëntor 2018, ushtroi të drejtën e tij për t'u njohur me aktet e fashikullit gjyqësor në Kolegj.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

21. *Subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka dhënë mundësinë reale për ushtrimin e barrës së provës, duke i mohuar të drejtën e realizimit efektiv të mbrojtjes dhe barazisë së armëve, pasi nuk iu ngarkua barra e provës lidhur me faktin e bashkëjetesës; nuk iu pranua asnjë nga 27 provat e kërkuara/depozituara në funksion të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ; në kundërshtim me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe Kodin e Procedurave Administrative nuk i janë bërë të njohura provat e administruara, provat që nuk janë marrë në konsideratë, si dhe rezultati i pritshëm i mundshëm, madje iu kërkuar të paraqiste shpjegimet brenda një kohe shumë të shkurtër 4-ditore, nga data e caktimit të seancës dëgjimore. Trupi gjykues, nga dokumentacioni i administruar në Komision dhe i shqyrtuar në Kolegj gjatë gjykimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, gjatë fazës së hetimit, në përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, ka dhënë shpjegime në lidhje me marrëdhënien e tij me bashkëjetuesen, si dhe për të ardhurat e saj, për efekt justifikimi të burimit të krijimit të pasurive të saj. Në mënyrë specifike, Komisioni, më datë 22.03.2018 i ka drejtuar subjektit pyetjen: “Ju lutem na informo, kur ka filluar bashkëjetesa juaj me znj. A.O.?” Subjekti, në përgjigje³, ka shpjeguar marrëdhënien e tij me znj. A.O.. Marrëdhënien e bashkëjetesës subjekti e ka sqaruar edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, dërguar në Komision më datë 18.07.2018, në përgjigje të gjetjeve të Komisionit*

³ Përgjigjet e subjektit janë depozituar në Komision me nr. {***} prot., datë 30.03.2018.

lidhur me justifikimin e burimeve të krijimit të pasurive të paluajtshme të znj. A.O.. Nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 26.07.2018, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar marrëdhënien e bashkëjetesës me znj. A.O. dhe kohën kur ka filluar kjo bashkëjetesë, madje më pas u është përgjigjur edhe pyetjeve të trupit gjykues mbi këtë çështje. Në analizë të kësaj situatë faktike, trupi gjykues arrin në përfundimin se çështja e bashkëjetesës së subjektit të rivlerësimit nuk është një çështje e posaçme, e gjetur/e shqyrtuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, por ajo është sjellë në diskutim dhe është pretenduar, në çdo rast, nga vetë subjekti, për të justifikuar kontributin e tij në rritjen e fëmijëve, si dhe për të theksuar se pasuritë e znj. A.O. janë krijuar në një periudhë kur ajo nuk ishte në marrëdhënie bashkëjetese me vetë subjektin. Komisioni në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, ka sqaruar pikërisht këtë pretendim konstant të subjektit në lidhje me marrëdhënien e tij të bashkëjetesës me znj. A.O..

22. Trupi gjykues konstaton se bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, të dërguara në Komision më datë 18.07.2018, subjekti ka paraqitur kërkesë me objekt “Marrje/administrim provash të reja”, në të cilën ka kërkuar që të merren akte në cilësinë e provës, si dhe ka kërkuar që të thirren disa persona në cilësinë e dëshmitarit. Komisioni, me vendimin e datës 23.07.2018 ka vendosur refuzimin e kërkesës së subjektit për thirrjen e dëshmitarëve, me arsyetimin se ajo nuk plotëson kushtet e një kërkesë të mirëfilltë procedurale dhe se marrja e këtyre provave është e panevojshme, për vendimmarrjen, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.
23. Në analizimin e këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues çmon të marrë në konsideratë jurisprudencën e GjEDNj-së, e cila në çështjen Wierzbicki k. Polonisë, 2002, është shprehur: *Neni 6 i Konventës nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën për të thirrur dëshmitarë apo për të paraqitur prova të tjera në gjykimet civile. Megjithatë, çdo kufizim i së drejtës së palës për të thirrur dëshmitarë apo për të paraqitur prova të tjera në mbrojtje të rastit të vet, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e procesit të rregullt, sipas nenit 6, paragrafi 1 i Konventës, duke përfshirë edhe parimin e barazisë së armëve. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se vlerësimi i rëndësisë së provave për çështjet konkrete është kompetencë e gjykatave të brendshme. Në rrethanat e kësaj çështjeje, Gjykata është e kënaqur që gjykatat e brendshme shqyrtuan kërkesat e aplikantit për të thirrur dëshmitarë dhe dhanë arsye të hollësishme për refuzimet e tyre, të cilat, sipas Gjykatës, nuk ishin të ndotura nga arbitrariteti. Për këto arsye, refuzimi për të marrë provat e propozuara nga kërkuesi nuk përbën një kufizim joproporcional të aftësisë së tij për të paraqitur argumente në mbështetje të rastit të tij gjatë gjykimit. Sa më sipër, nuk ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 38/2010 është shprehur: Nëse gjykatat e zakonshme vërejnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë. Kjo nuk bëhet për të siguruar vetëm respektimin e barazisë së armëve, por dhe të parimit të kontradiktoritetit të gjykimit ose të shqyrtimit të provave. Nën dritën e zbatueshmërisë së parimeve të barazisë së armëve dhe mbrojtjes efektive, për sa i përket së drejtës për të thirrur dëshmitarë dhe pranueshmërisë së dëshmive, në rastin konkret, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, drejtësisht, ka arsyetuar se dëshmia e personave të kërkuar për t’u thirrur si dëshmitarë nuk kishte asnjë relevancë në marrjen e vendimit dhe, për rrjedhojë, nuk ka shkelje të parimeve të procesit të rregullt, për sa i përket refuzimit të marrjes së provës me dëshmitarë.*
24. Në lidhje me pretendimin e subjektit se ishte detyrim i Komisionit që, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Kodin e Procedurave Administrative, t’i bënte atij të njohura provat e administruara, provat që nuk janë marrë në konsideratë, rezultatit e pritshëm të mundshëm, si dhe

t'i bënte të njohur vendimin për fillimin e hetimit të thelluar administrativ dhe motivimin e fillimit të këtij hetimi, në një kohë kur organet e ngarkuara nga ligji nr. 84/2016 kishin dhënë vlerësime pozitive, trupi gjykues vlerëson se procedura e rivlerësimit është e përcaktuar plotësisht në ligjin e posaçëm nr. 84/2016, në kreun VII, nenet 45-61 të tij, me referencat përkatëse në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me të drejtat e subjektit gjatë kësaj procedure. Procedura e rivlerësimit e parashikuar nga ligji nr. 84/2016 ka elemente të konsiderueshme ngjashmërie me procedurën administrative të parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative. Në përputhje me ligjin e posaçëm nr. 84/2016, Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 30.11.2017, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Fillimi i hetimit të thelluar administrativ është detyrë funksionale e Komisionit, bazuar në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: "1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit", si dhe në qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit Komisioni dhe Kolegji hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes dhe kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli e vlerësimi, pa u bazuar dhe pa qenë të detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet ligjzbatuese, ILDKPKI-ja në rastin konkret. Me vendimin nr. 02, datë 06.07.2018, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ dhe të njoftojë subjektin për rezultatet e tij, duke i kaluar barrën e provës, bazuar në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për t'u njohur me provat e administruara dhe mbi të drejtat që gëzon nga ligji në këtë proces. Ky vendim i është bërë i njohur subjektit nëpërmjet postës elektronike.

Në rezultatet e hetimit administrativ, të cilat përmbajnë rezultatin e pritshëm të hetimit, për çdo gjetje është shprehur qartë se në cilat prova është bazuar, duke i cituar ato. Për çdo gjetje, rezultatet e hetimit përmbajnë analizën e provave dhe analizën financiare. Sipas deklaratës së nënshkruar nga vetë ai, më datë 10.07.2018, subjekti është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e dosjeve të hetimit administrativ, fakt i pohuar prej tij edhe në seancë dëgjimore. Pas njohjes me dosjen dhe rezultatet e hetimit, subjekti ka paraqitur më datë 18.07.2018, shpjegimet dhe provat që ai i ka konsideruar të nevojshme. Me vendimin nr. 03, datë 23.07.2018, trupi gjykues ka vendosur të ftojë subjektin në seancë dëgjimore më datë 26.07.2018. Ky vendim i është njoftuar subjektit nëpërmjet postës elektronike. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti ka shpjeguar të gjitha momentet që ai i ka konsideruar të nevojshme për mbrojtjen e tij. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti ka shprehur argumentet e tij, ai është dëgjuar dhe, në përfundim, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ka shpallur vendimin.

25. Lidhur me pretendimin e subjektit se nga Komisioni iu kërkua të paraqiste shpjegimet brenda një kohe shumë të shkurtër, 4-ditore, nga data e caktimit të seancës dëgjimore, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve procedurale të Komisionit, konstaton se më datë 06.07.2018, Komisioni ka njoftuar subjektin për përfundimin e hetimit administrativ dhe për njohjen me rezultatet e këtij hetimi, duke i lënë afat për të dhënë shpjegime me shkrim deri në datën 18.07.2018, pra brenda 12 ditësh. Subjekti nuk ka kërkuar zgjatje të afatit të mësipërm dhe i është përgjigjur Komisionit më datë 18.07.2018. Më datë 23.07.2018, Komisioni i ka njoftuar subjektit ftesën për seancë dëgjimore në datën 26.07.2018, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore, por është paraqitur së bashku me mbrojtësin e tij. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe nuk ka paraqitur asnjë pretendim për kohën që ka pasur në dispozicion për përgatitjen për këtë seancë.

Sa më sipër, rezulton se Komisioni i ka garantuar subjektit të gjitha të drejtat procedurale dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i tij është i pabazuar.

26. *Subjekti pretendon se Komisioni i ka mohuar të drejtën kushtetuese për t'u dëgjuar/gjykuar drejtësisht, pasi nuk u kujdes kryesisht për zhvillimin e seancës dëgjimore me dyer të mbyllura, sipas neneve 58/a, 103, 104 dhe 340 të Kodit të Procedurës Penale, duke shkelur nenin 8 të KEDNj-së, kur në të do të diskutohej jeta private e bashkëjetueses së tij dhe familjarëve të saj; nuk ka analizuar fakte dhe rrethana me rëndësi për çështjen, si dhe ka fshehur e manipuluar fakte me pasojë shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor. Trupi gjykues, duke shqyrtuar këtë shkak ankimi në raport me aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, konstaton se në pyetësorët drejtuar subjektit të rivlerësimit, si dhe në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk ka përmendur në asnjë moment elemente që lidhen me fakte ngushtësisht personale të bashkëjetueses subjektit, të cilat nuk lidheshin me procesin e rivlerësimit dhe nuk provohet të ketë hetuar në asnjë rast në këtë drejtim. Përkundrazi, ka qenë subjekti i rivlerësimit që i ka paraqitur Komisionit prova për rrethana dhe fakte personale të znj. A.O., me qëllim provimin e situatës faktike mes tyre, e cila sipas tij nuk duhej të konsiderohej si bashkëjetesë para vitit 2012. Gjatë seancës dëgjimore të datës 26.07.2018, subjekti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për mënyrën e zhvillimit të seancës. Nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 26.07.2018, rezulton se relatorja e çështjes, në asnjë moment gjatë prezantimit të dosjes së rivlerësimit, nuk ka përmendur të dhëna për fakte personale të bashkëjetueses së subjektit, përtej atyre që lidheshin me procesin e rivlerësimit, dhe për të cilat ajo ka lëshuar autorizimin përkatës në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Faktet e pretenduara nga subjekti si të debatuar në seancën dëgjimore në Komision, jo vetëm nuk janë trajtuar, por rezulton se trupi gjykues dhe vetë subjekti kanë qenë të kujdesshëm të mos i përmendin ato. Trupi gjykues vlerëson se bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë, kur është rasti, edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në Kodin e Procedurës Civile. Procesi i rivlerësimit është një proces administrativ dhe për këtë arsye gjatë zhvillimit të tij nuk mund të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, siç pretendon subjekti. Në lidhje me elementet e tjera të mbrojtjes së jetës private të subjektit të rivlerësimit ose bashkëjetueses së tij, të pretenduara si të cenuara në kuadrin e nenit 8 të KEDNj-së, trupi gjykues çmon se ato u nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, i cili rreshton në mënyrë shteruese të drejtat kushtetuese, që u nënshtrohen kufizimeve të pjesshme dhe të përkohshme gjatë procesit të rivlerësimit, për aq kohë sa do të zgjasë procesi i rivlerësimit kalimtar dhe për aq sa do të jetë e nevojshme për të arritur garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Trupi gjykues arrin në përfundimin se procesi i rivlerësimit për subjektin është kryer brenda kufijve të përcaktuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, pa tejkalluar në asnjë rast qëllimin e tyre.*
27. *Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka fshehur faktet duke mos analizuar dokumentet shpresore të depozituara prej tij, të cilat hidhnin dritë mbi faktin se kur ka filluar bashkëjetesa e tij me znj. A.O., trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, konkluzionin e tij për momentin e fillimit të bashkëjetesës së subjektit me znj. A.O. e ka arsyetuar duke analizuar provat mbi të cilat është mbështetur, të cilat janë deklaratat e pasurisë së subjektit në vite dhe informacione të përcjella nga Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Trupi gjykues vlerëson se Kodi i Procedurës Civile në nenin 29 të tij përcakton se gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë*

e tyre të rrethanave të çështjes. Edhe GjEDNj-ja, në jurisprudencën e saj është shprehur se sipas nenit 6/1 të Konventës, vlerësimi i provave është kompetencë e gjykatave të brendshme⁴, për pasojë nuk hyn në sferën e aplikimit të parimit të procesit të rregullt ligjor. Por, megjithëse gjykatat e brendshme kanë një marzh të caktuar vlerësimi, kur zgjedhin argumentet dhe vlerësojnë provat, është e detyrueshme për to të justifikojnë këto veprime duke i arsyetuar në vendim⁵. Duke zbatuar jurisprudencën e mësipërme në çështjen konkrete, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, ka vlerësuar provat dhe ka arsyetuar mbi ato që i ka konsideruar relevante në zgjidhjen e drejtë të çështjes.

28. Subjekti pretendon se Komisioni ka bërë manipulim të fakteve, pasi në vendim, të ardhurat në vlerën 4407497 lekë, të përfituara nga shitja e një apartamenti sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2008, dhe të dhënave bankare të z. Rr.O, babait të bashkëjetueses, i janë llogaritur këtij të fundit në vitin 2009, kur në fakt ato janë përfitur në vitin 2008, çka përkon me kohën kur prindërit e znj. A.O. kanë dhënë kontribut financiar për krijimin e pasurive të saj. Trupi gjykues konstaton se, referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (në vijim “ZVRPP”), me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2018, rezulton e provuar se z. Rr. O. në cilësinë e palës shitëse dhe z. F. Ç. në cilësinë e palës blerëse kanë lidhur kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2008, për shitjen e pasurisë së apartament me sipërfaqe 79,4 m², rruga “{***}”, Tiranë, në vlerën 4407497 lekë. Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Banka Amerikane e Investimeve, me shkresën nr. {***}, datë 17.01.2018, rezulton që në datë 24.10.2008, z. F. Ç. ka derdhur në llogarinë e z. Rr. O. shumën 36000 euro, me përshkrimin “Derdhur nga F. Ç., për blerje apartamenti”. Nga verifikimi i tabelës financiare nr. 2 të vendimit të Komisionit nr. 51, datë 30.07.2018, trupi gjykues konstaton se shuma prej 4407497 lekësh është konsideruar nga Komisioni si e ardhur e krijuar nga z. Rr. O. në vitin 2009. Nga verifikimi i të dhënave të llogarisë së z. Rr. O. në Bankën Amerikane të Investimeve⁶, të administruara gjatë hetimit në Komision, rezulton se në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, z. Rr. O. ka kryer tërheqje parash nga këto të ardhura në vitin 2009, ndërsa znj. A.O., pagesat për pasuritë e saj të paluajtshme i ka kryer brenda vitit 2008. Për këtë arsye, trupi gjykues arrin në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se z. Rr.O. nuk mund të jepte kontribut nga këto të ardhura, për krijimin e pasurisë së vajzës së tij.
29. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka fshehur ekzistencën e njërës prej depozitave të z. Rr.O., në Alpha Bank, në vlerën 58240 USD gjendje në datën 18.12.2003, në llogarinë me numër {***}, trupi gjykues konstaton se vetë subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me depozitën e sipërcituar, ka paraqitur dokumentacionin bankar të Alpha Bank, që i përket llogarisë në emër të z. Rr.O. për periudhën 2000-2018. Sipas të dhënave të këtij dokumentacioni, z. Rr.O. ka tërhequr shumën 52540 USD, më datë 18.12.2003, për pasojë gjendja e llogarisë së depozitës, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, në këtë datë është 5.702 USD. Tërheqja e kësaj shume nga z. Rr.O. përkon me nënshkrimin prej tij të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2003⁷, për blerjen e një shtëpie prej 42,8 m² dhe truallit prej 92,8 m², në Tiranë, në vlerën 54.000 USD. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni nuk ka fshehur ekzistencën e gjendjes së depozitës së z. Rr.O.,

⁴ Shih çështjen *Centro Europa SRL dhe Di Stefano k. Italisë*, 2012.

⁵ Shih çështja *Suominen k. Finlandës*, 2003.

⁶ *Ish-Emporiki Bank*.

⁷ *Kjo kontratë është paraqitur në Komision si informacion nga ZVRPP, Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2018.*

por me të drejtë nuk i ka dhënë relevancë gjatë vlerësimit të pasurisë së bashkëjetueses së subjektit, pasi kjo shumë nuk lidhet me krijimin e pasurive të saj.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

30. *Subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit ka qenë dukshëm i paragjykuar dhe vendimmarrja e paracaktuar, pasi vendimi i Komisionit është marrë pa vlerësimin dhe analizën e duhur të provave, për pasojë ky vendim është i paarsyetuar, kontradiktor, me gabime materiale, me shprehje denigruese e cinike. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit është në përputhje të plotë me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016. Ai përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe caktimin e masës disiplinore. Në vendim është bërë një analizë e plotë e provave, të cilat janë përdorur për vlerësimin e pasurisë, figurës dhe vlerësimit profesional. Për secilën pasuri apo të ardhur të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet dhe pretendimet e subjektit duke i cituar ato herë pas here, deklaratat e personave të lidhur me të, si dhe janë dhënë shpjegimet për mospranimin e kërimit të provave me dëshmitarë. Vendimi i Komisionit është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁸ dhe të GjEDNj-së. Kjo e fundit në çështjen Garcia Ruiz v. Spain, 1999, është shprehur se neni 6/1 i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, por kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument. Trupi gjykues arrin në përfundimin se arsyetimi i vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit është i plotë, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit.*
31. *Subjekti pretendon se në faqen 11 të vendimit është shënuar “{***}” ShPK, me vlerë 100.000 lekë, bashkëjetuesja 100%”, kur në fakt vlera e aksioneve është “100 lekë”. Nga verifikimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se në faqen 11 të tij, në citimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit, Komisioni ka shprehur gabimisht vlerën 100.000 lekë për aksionet e shoqërisë “{***}” ShPK, pasi ato janë në vlerën 100 lekë, referuar deklaratimit të personit të lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe informacionit të përcjellë në ILDKPKI nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.07.2017. Trupi gjykues konstaton se shifra e aksioneve të shoqërisë “{***}” ShPK, e cituar gabim nga Komisioni në faqen 11 të vendimit, është cituar saktë më pas, në faqen 28 të tij, dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë për subjektin e rivlerësimit në drejtim të ngarkimit të tij me përgjegjësi disiplinore.*
32. *Subjekti pretendon se në faqen 16 të vendimit, të ardhurat e znj. A. O. janë shënuar në vlerën 27.241 USD, kur në realitet të ardhurat e saj në vitin 2007 kanë qenë 63.749 USD + 127.241 USD. Nga verifikimi i vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në faqen 16 të tij, është cituar nga Komisioni deklarimi i subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e përcjella në Komision në datë 30.03.2018 dhe rezulton se Komisioni shifrën 127.241 USD⁹ të cituar nga subjekti, e ka shënuar në vlerën 27.241 USD. Ky gabim material në vendimin e Komisionit, i cili duket se është një lapsus gjatë një citimi të gjatë të deklarimit të subjektit të rivlerësimit, nuk ka sjellë asnjë pasojë për vlerësimin, pasi këto vlera subjekti i ka cituar për të vërtetuar aftësinë financiare të motrës së bashkëjetueses së tij, znj. A.O., për t'i dhënë asaj shumën prej 38.500 USD, gjatë vitit 2007. Komisioni, në vazhdim, në faqen 22 të vendimit, ka njohur mundësinë financiare të znj. A. O. për t'i dhënë bashkëjetueses së subjektit shumën e dekluar prej saj.*

⁸ Vendimi nr. 12, datë 19.3.2015 dhe vendimi nr. 26, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

⁹ Kjo vlerë provohet nga deklarata e avokatit Michael G. O'Neil, datë 17.05.2018, New York.

33. Subjekti pretendon se në faqen 37, paragrafi 2 i vendimit, Komisioni ka përdorur shprehje denigruese dhe në kundërshtim me aktet e seancës dëgjimore të datës 26.07.2018. Trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, në paragrafin e cituar më sipër, konstaton se Komisioni është shprehur ashtu siç ka cituar subjekti në pretendimin e tij. Trupi gjykues çmon se Komisioni, pavarësisht sesi është shprehur subjekti i rivlerësimit, mund të kishte treguar vëmendje më të madhe në mënyrën e të shprehurit për këtë argument, por megjithatë duket qartë që qëllimi nuk ka qenë kurrësi denigrimi i subjektit të rivlerësimit.
34. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shprehja e Komisionit në faqen 19, paragrafi 4 i vendimit se shpjegimet e subjektit kanë qenë tepër voluminoze, të paqarta e të pasakta në lidhje me kontributin e tij financiar për pasuritë e blera nga bashkëjetuesja, është cinike dhe nuk përputhet me faktet, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, bazuar në tagrin e vet ligjor, të përcaktuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, ka shprehur një konkluzion në lidhje me qëndrimin e subjektit në raport me shpjegimet e dhëna prej tij gjatë procesit të rivlerësimit. Të njëjtin konkluzion, Komisioni e ka shprehur edhe në faqen 4 të vendimit, paragrafi 14 me titull “Qëndrimi dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit”.
35. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi i Komisionit është kontradiktor, pasi në faqen 25 të tij Komisioni pranon se në të ardhurat e prindërve të znj. A.O. janë përfshirë të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat të z. Rr.O., ndërsa në analizën financiare rezultojnë se këto të ardhura nuk janë analizuar në asnjë moment, trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit të Komisionit nr. 51, datë 30.07.2018, konstaton se të ardhurat e prindërve të znj. A.O. janë përlllogaritur për të dy së bashku. Këto të ardhura, siç është shprehur Komisioni në vendim¹⁰, përbëhen nga: të ardhurat e siguruar nga pensionet, nga ushtrimi i aktivitetit si avokat i z. Rr.O. (ato të ardhura të provuara me dokumentacion), të ardhurat e siguruar nga shitja e pasurive të paluajtshme, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i të ardhurave të pasqyruara në tabelën nr. 4 të vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në kundërshtim me sa ka pretenduar subjekti, në të ardhurat e prindërve të znj. A.O. janë përfshirë të ardhurat e z. Rr.O. nga aktiviteti i tij si avokat.
36. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni, në vendim, shprehet që bashkëjetuesja e tij ka paguar vlerën 131.500 euro dhe ka marrë mbrapsht diferencën, e cila është përfshirë në llogaritje, por në fakt rezultojnë se kjo diferencë nuk është analizuar dhe pasqyruar në asnjë moment, trupi gjykues konstaton se në tabelën nr. 3 të analizës financiare të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit, vlera e përlllogaritur për pasurinë apartament 66,60 m² në ish-pronësi të bashkëjetueses së subjektit është 7.758.900 + 14.500 euro, e cila në kundërshtim me sa pretendon subjekti, rezultojnë të jetë vlera pas kthimit të shumave nga shoqëria sipërmarrëse.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

37. *Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është në shkelje të hapur të parimeve të mosdënimit pa ligj dhe mospërgjegjësisë pa faj.* Në analizë të këtij shkak ankimi, trupi gjykues çmon se megjithëse parimet e pretenduara si të shkelura nga vendimmarrja e Komisionit i përkasin fushës së të drejtës penale, analiza e këtij shkak ankimi do të bazohet në verifikimin e respektimit të këtyre parimeve në procesin administrativ të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës përcakton qëllimin e deklaramentit dhe kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, i cili është identifikimi i atyre që kanë në pronësi apo përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i

¹⁰ Shih paragrafin e tretë, faqe 25 të vendimit të Komisionit nr. 51, datë 30.07.2018.

kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me shtojcën nr. 2 të këtij ligji, sipas së cilës personat e lidhur me subjektin, nëse disponojnë pasuri veçmas, kanë detyrimin të plotësojnë dhe nënshkruajnë pjesën e veçantë “Deklaratë e pasurisë e personit të lidhur”. Ligji nr. 84/2016 në nenin 3, pika 13 cilëson rrethin e personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, duke përfshirë në të bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Pasuritë e këtyre personave, ligjshmëria e burimit të krijimit të tyre, përmbushja e detyrimeve financiare, përfshirë dhe interesat privatë janë objekt i vlerësimit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 30 të ligjit të sipërcituar, ndërsa neni 32 në pikat 1, 3 dhe 4 vendos detyrim të njëjtë si për subjektin e rivlerësimit, ashtu dhe për personat e lidhur me të, si dhe për persona të tjerë të lidhur me ta, për deklarimin e pasurisë brenda ose jashtë vendit dhe dokumentimin e burimit të krijimit të saj. Si pasojë e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të sipërpërmendura, subjektit të rivlerësimit i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi/bashkëpronësi, posedim ose në përdorim të tij apo të personave të lidhur me të. Kontrolli i pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personin/personat e lidhur me të fillon nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit dhe shtrihet edhe në deklaramet e viteve të mëparshme, për të verifikuar saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramet të pasurisë dhe interesave privatë të tyre. Në këtë kuptim, pasuria e personit/personave të lidhur bëhet objekt kontrolli, si rezultat i faktit të deklaramet të këtyre personave si persona të lidhur, në momentin e plotësimit të deklaramet së pasurisë së rivlerësimit nga subjekti i rivlerësimit.

38. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 përcakton dhënien e masës disiplinore për subjektin e rivlerësimit, kur rezulton se ka bërë deklaramet të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Trupi gjykues çmon se dispozitat e ligjit nr. 84/2016 duhen interpretuar në mënyrë të lidhur me njëra-tjetrën. Kështu, bazuar në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji parashikohet kontrolli dhe verifikimi i pasurisë për personin e lidhur me të njëjtën procedurë si për subjektin e rivlerësimit, ndërsa neni 52 i ligjit nr. 84/2016 përcakton kalimin e barrës së provës te subjekti i rivlerësimit. Parimi i kalimit të barrës së provës te subjekti i rivlerësimit rrjedh nga parashikimi i pikës 5 të nenit 4 të Aneksit të Kushtetutës, ndërsa në nenin D, pika 5 është detajuar se ky kalim bëhet kur ndaj subjektit zbatohet parimi i prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit. Pamjaftueshmëria në deklaramet, e parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 përfshin jo vetëm deklaramet e subjektit, por edhe atë të personit/personave të lidhur me të, të deklaruar si të tillë në deklaramet e pasurisë së rivlerësimit. Përgjegjësia disiplinore e përcaktuar në këtë nen i përket subjektit të rivlerësimit, pasi ai është subjekti i cili i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Duke e qasur këtë interpretim në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij si person i lidhur me të, në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarametve të interesave pasurore në deklaramet e rivlerësimit krahasuar me ata të deklarametve periodike, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe pagimit të detyrimeve financiare. Gjithashtu, hetimi është shtrirë edhe për saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarametve të interesave pasurore në deklaramet e rivlerësimit dhe ligjshmërinë së burimit të krijimit të pasurisë për personat e lidhur me subjektin, sipas përbërjes së certifikatës së tij familjare. Komisioni, në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, ka analizuar dhe arsyetuar se subjekti i rivlerësimit së bashku me personin/personat e lidhur ndodhet në kushtet e deklaramet të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të

Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 gjen zbatim si pasojë e kësaj gjendjeje fakti, konstatuar gjatë hetimit administrativ, për qëllim të procesit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

39. *Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, si dhe parimin e ushtrimit të së drejtës për t'u dëgjuar, pasi referuar rezultateve të hetimit administrativ atij nuk i ka kaluar barra e provës për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, ndërkohë që në seancën dëgjimore të datës 26.07.2018, relatorja e çështjes në mënyrë të papritur ngriti si problematikë “zvarritje procesi në një çështje civile” apo “ndryshimin e vendimit të një mase sigurimi nga Gjykata e Apelit”. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, konstaton se Inspektorati i KLD-së, në raportin për subjektin e rivlerësimit ka analizuar kryesisht probleme që kanë të bëjnë me shkelje të afateve në gjykimin e çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ka informuar mbi një ankesë të vitit 2014, për zvarritje dhe mosrespektim formal të ligjit, për të cilën gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim nga KLD-ja. Në paragrafin e fundit të rezultateve të hetimit administrativ, bërë të njohura subjektit më datë 06.07.2018, Komisioni shprehet se për sa u përket rezultateve të hetimit, subjekti ka barrën e provës vetëm për kriterin e pasurisë, ndërsa për dy kriteret e tjera, rezultatet gjenden në raportet përkatëse, pjesë e dosjes së rivlerësimit. Në seancën dëgjimore të datës 26.07.2018, relatorja e çështjes ka bërë prezantimin e dosjes së rivlerësimit, duke prezantuar edhe gjetjet e raportit të Inspektoratit të KLD-së, me të cilat rezultoi e provuar se subjekti ishte njohur për shkak të njohjes me dosjen e rivlerësimit. Në seancën dëgjimore, subjekti ka shpjeguar edhe qëndrimin e tij në lidhje me këto gjetje. Në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, Komisioni ka dhënë vlerësimin “i aftë”, për aftësitë profesionale të subjektit, duke mos e ngarkuar atë me përgjegjësi disiplinore. Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjektit nuk i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe as cenuar procesi i rregullt ligjor, ***për pasojë vlerëson se pretendimi i tij është i pabazuar.****
40. *Subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e tij, duke riçelur/përsëritur hetimin gjyqësor me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, pasi hetimi administrativ dhe gjyqësor i Komisionit është i pavlefshëm për shkak të shkeljeve procedurale të cituara në shkaqet e mësipërme të ankimit. Trupi gjykues vlerëson se neni 51 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), përmban rastet kur gjykata duhet të vendosë për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në zbatueshmërinë e përcaktimeve të këtij neni për çështjen konkrete, trupi gjykues, në kundërshtim me sa ka pretenduar subjekti, nuk konstaton shkelje procedurale të kryera nga Komisioni gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit. Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka qenë i rregullt dhe nuk u provuan shkaqe për pavlefshmëri të tij.*
41. *Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me ankimin akte, të cilat ka kërkuar që të merren në cilësinë e provës. Trupi gjykues konstaton se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë akte të paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, të administruara në dosjen e rivlerësimit, për këtë arsye nuk mund të cilësohen si prova të reja, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Trupi gjykues vlerëson se, duke qenë se u provua që hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka qenë i rregullt, përsëritja e marrjes në shqyrtim të provave të paraqitura nga subjekti gjatë procesit në Komision, është e panevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Vendimmarrja e Komisionit ka qenë në përputhje të plotë me parimet e procesit të rregullt ligjor, duke i garantuar subjektit të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016.*

42. Për aktet e tjera të paraqitura nga subjekti bashkëlidhur ankimit, të cilat konsiderohen si prova të reja¹¹, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, trupi gjykues, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos i pranojë këto akte, pasi i konsideroi ato si të panevojshme për shqyrtimin e çështjes.
43. Subjekti, më datë 05.06.2019, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet me shkrim, pas njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi. Në të njëjtën datë, subjekti paraqiti edhe shtatë kërkesa për marrje provash të reja, bashkëlidhur të cilave ka paraqitur akte shkresore, një pjesë e të cilave gjenden në dokumentacionin e administruar nga Komisioni. Aktet e tjera, të paraqitura për herë të parë nga subjekti, trupi gjykues vendoi të mos i pranojë, pasi vlerësoi se bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në këtë fazë të procesit palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja. Në shqyrtim të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti 5 ditë para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, trupi gjykues konstaton se subjekti ka paraqitur edhe disa shkaqe të reja ankimi, përtej atyre të parashtruara në ankimin e depozituar brenda afatit ligjor 15-ditor, sipas parashikimeve të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me këto shkaqe të reja ankimi të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk duhet të pranohen e shqyrtohen prej tij, në përputhje me parashikimin e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cili parashikon se parashtrimet e paraqitura nga palët, jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të seancës në dhomë këshillimi, duhet të kenë lidhje vetëm me shkaqet e ankimit ose kundërankimit. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 179/b, pikat 2 e 5 të Kushtetutës, në nenin F, pikat 1 e 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 459 dhe 465, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit e shqyrton çështjen duke marrë në analizë vetëm shkaqet që ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim, dhe jo shkaqet e reja të parashtruara pas përfundimit të afatit të ankimit.
44. Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit. Për këtë arsye, shqyrtimi i ankimit të subjektit u zhvillua në dhomë këshillimi, në bazë dokumentesh.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

45. Shkaqet e ankimit në aspektin faktik, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtimin e vendimit të Komisionit nr. 51, datë 30.07.2018, lidhen me konkluzionet e Komisionit se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij, znj. A.O., kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e dy pasurive të paluajtshme, të deklaruara nga bashkëjetuesja në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
46. *Subjekti pretendon se Komisioni, duke analizuar dhe konkluduar rreth një marrëdhënieje personale me karakter pasuror siç është bashkëjetesa, mbi fshehjen nga subjekti i rivlerësimit të*

¹¹ Vendim i GjEDNj-së, çështja Volkov k. Ukrainës, 2013; certifikatë vdekjeje e të ndjerit N. A.; vendim nr. [***], datë 23.05.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë; ekstrakt nga gazeta “Shqiptarja.com”; ekstrakt nga “Pamflet” online; ekstrakt nga gazeta “Tema”; ekstrakt Monitori i Medias; ekstrakt nga gazeta “Shqiptarja.com”, datë 30.07.2018; ekstrakt i QKB-së për Multiscreen; kërkim elektronik në sistemin hipotekor për pronën me nr. [***], nga kërkuesi A. O., me datë kërrimi 13.03.2014 dhe anulim transaksioni me pronën datë 17.04.2018; “Kontratë e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore” nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 28.20.2011, redaktuar nga notere Mimoza Shehu; draft-kontratë shitje pasurie e paluajtshme (apartament banimi), datë 17.03.2014, me palë M. H., Suela Zhegu (dhënie pëlqimi Idi Zhegu); printime nga interneti të artikujve gazetareskë për komisioneren Suela Zhegu, në lidhje me çështjen gjyqësore ku ka qenë palë ajo ose bashkëshorti i saj; vendim nr. [***], datë 19.09.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë; vendim nr. [***], datë 27.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë; procesverbal mbi shpjegimet e subjektit deklarues në ILDKPKI, datë 11.09.2014; rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ për vitin 2016; certifikatë familjare e Bledar Abdullai, Njësia Administrative nr. [***], datë 09.07.2018.

kësaj marrëdhënieje me znj. A.O. që në vitin 2004, ndërkohë që subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se bashkëjetesën e ka filluar në vitin 2012, ka shkelur parimet e shtetit të së drejtës, në tejkalim të kompetencave dhe juridiksionit që i njeh Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 dhe njëherësh ka shkelur të drejtat mbi jetën private dhe të drejtën e familjes së subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, në faqen 31, ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie të vazhdueshme me bashkëjetuesen që nga viti 2004 e në vijim. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja e tij, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, kanë deklaruar se marrëdhënia e bashkëjetesës mes tyre ka filluar në vitin 2012. Në shkaqet e ankimit, subjekti, në mbështetje të pretendimit të tij, ka renditur këto fakte:

a) bashkëjetesën me znj. A.O. e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2012; b) znj. A.O. ka qenë rezidente e përhershme në ShBA në vitet 2000-2005 dhe në këtë periudhë ka kryer studimet universitare atje; c) pas vitit 2005, ajo është kthyer përkohësisht në Shqipëri dhe ka jetuar me familjen e trugut të origjinës në adresën rruga “{***}”, pallati {*}, shkalla {*}, ap. {*}, Tiranë; ç) në periudhën 2006-2008, për arsye personale nuk mund të fillonte bashkëjetesën me subjektin; d) nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se në vitet 2007, 2008, 2009, ajo ka jetuar në ShBA për periudha kohore më të gjata se 3 muaj, prandaj informacioni i përcjellë në Komision nga Ministria e Drejtësisë, sipas të cilit znj. A.O. ka punuar në këtë institucion pa ndërprerje, duhet parë në harmoni me këto të dhëna; dh) subjekti para vitit 2012 ka jetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje me vëllain e tij me qira në zona të ndryshme të Tiranës, prandaj ka deklaruar si adresë alternative në deklaratat e vitit 2005 apo 2007 adresën e banimit të prindërve apo motrës së personit të lidhur, znj. A.O..

47. Në analizë të pretendimeve të subjektit, nga aktet e administruara gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues konstaton se subjekti e ka deklaruar znj. A.O. në cilësinë e personit të lidhur, bashkëjetueses, duke filluar nga deklarimi i pasurisë së vitit 2012 e në vijim. Nga verifikimi i përmbajtjes së deklaratave periodike të pasurisë në vite rezulton se në vitin 2012, për herë të parë, formulari i deklarimit të pasurisë, në faqen 2, parashikoi detyrimin për deklarimin e bashkëjetuesit/es në rrethin e personave të lidhur me zyrtarin deklarues. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se fakti që subjekti ka deklaruar bashkëjetuesen në rrethin e personave të lidhur në deklarimin e pasurisë së vitit 2012, nuk provon plotësisht se bashkëjetesa ka filluar në këtë vit. Fakti i pretenduar nga subjekti se znj. A.O. ka qenë rezidente e përhershme në ShBA në periudhën 2000-2005 nuk provon në mënyrë të plotë se ajo nuk ka bashkëjetuar me subjektin e rivlerësimit, pasi qenia rezidente e përhershme e detyronte znj. A.O. të rikthehej në ShBA të paktën një herë në vit për të rinovuar lejen e punës dhe të qëndrimit atje. Në periudhën e pretenduar të bashkëjetesës 2012 e në vijim, znj. A.O. ka shtetësi amerikane dhe ky fakt nuk e ka penguar të bashkëjetojë me subjektin e rivlerësimit. Në të njëjtin përfundim, trupi gjykues mbërrin edhe për faktin e shkollimit të znj. A.O. në ShBA deri në vitin 2005.
48. Në lidhje me pretendimin e subjektit se znj. A.O., për arsye personale, për shkak të të cilave nuk mund të hynte në marrëdhënie bashkëjetese me subjektin e rivlerësimit, në vitet 2007, 2008, 2009, ka jetuar në ShBA për periudha kohore më të gjata se 3 muaj, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstaton se sipas informacionit të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, znj. A.O. ka qenë e punësuar me kohë të plotë në këtë institucion, nga data 05.06.2006 deri më 04.11.2011. Në informacionin e dërguar në Komision nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore rezulton se znj. A.O. ka përfituar pagesa për përfitimet afatshkurtra për periudhën 01.06.2007 - 06.07.2007 dhe 07.09.2009 - 07.04.2010. Trupi gjykues, duke i analizuar në harmoni të dhënat e përcjella nga institucionet e sipërcituara, konstaton se në kundërshtim me sa pretendon

subjekti, znj. A.O. për periudhën kohore kur ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë, periudhat më të gjata të shkëputjes nga puna, të cilat përkojnë me qëndrimin në ShBA, i ka pasur të justifikuar me raport mjekësor. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se qëndrimi i bashkëjetueses te familjarët e saj në ShBA nuk provon plotësisht se marrëdhënia e bashkëjetesës nuk ka ekzistuar, pasi znj. A.O. edhe pas vitit 2012, kur pretendohet se ka nisur bashkëjetesa, ka vijuar të udhëtojë në ShBA te familjarët e saj, madje në periudha më të gjata qëndrimi sesa para vitit 2012¹².

49. Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë së subjektit në vite, trupi gjykues e vlerëson të saktë konstatimin e Komisionit në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, në faqen 30, se subjekti ka deklaruar si adresë banimi, që nga viti 2004 e në vijim, adresën e bashkëjetueses ose të prindërve/motrës së saj. Subjekti pretendon se i ka deklaruar këto si adresa alternative, pasi deri në vitin 2012 ka jetuar me qira me vëllain e tij. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit nuk është bindës, pasi formulari i deklarimit të pasurisë, në lidhje me adresën e zyrtarit deklarues është shumë i qartë, pasi ka kërkuar vazhdimisht deklarimin për adresën e plotë ku subjekti është regjistruar në gjendjen civile dhe adresën e plotë ku subjekti banon. Formulari në asnjë rast nuk jep mundësinë e deklarimit të një adrese alternative, pasi për adresë komunikimi, në rast prezumimi se nuk është deklaruar saktë adresa e banimit të subjektit, përdoret adresa e institucionit ku punon subjekti, e cila kërkohet të deklarohet e plotë në faqen e parë të tij. Trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar dhe provuar me certifikatë familjare se ai ka qenë dhe është i regjistruar në një trung familjar me familjen e tij të origjinës. Sipas deklarimit të pasurisë në vitet 2004-2015, ai ka deklaruar se është i regjistruar në gjendjen civile të Njësisë Administrative Nr. { * }, ndërsa nga viti 2016 në atë Nr. { * }. Pra, e gjithë familja e tij e origjinës ka qenë e regjistruar në këto njësi administrative, ndërsa prindërit e tij kanë jetuar dhe punuar në Kutalli, Berat, dhe në vitin 2012 kanë dalë në pension pleqërie, e më pas kanë filluar të jetojnë në Tiranë. Subjekti, megjithëse pretendon se nuk ka jetuar me znj. A.O., pra se ka jetuar në adresa të ndryshme nga ato që ka deklaruar, nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar se ka jetuar me qira me vëllain e tij dhe as se ku ka jetuar konkretisht. Pretendimi i vazhdueshëm i subjektit gjatë gjithë procesit të rivlerësimit në Komision, por edhe në ankim, se bashkëjetesa me znj. A.O. ka filluar në vitin 2012 lidhet ngushtësisht dhe pazgjydhshëmrisht me pretendimin tjetër të tij se pasuritë e znj. A.O. janë vënë para bashkëjetesës, se ata kanë regjim pasuror të ndarë dhe për këtë arsye subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore për shkak se znj. A.O. nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive të saj. Trupi gjykues vlerëson se në procesin e rivlerësimit, rëndësia e përcaktimit të momentit të fillimit të bashkëjetesës së subjektit lidhet me përlogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të tij dhe personit të lidhur, për efekt të jetesës së përbashkët dhe për rritjen e fëmijëve të lindur prej tyre, si edhe për krijimin e pasurive kur deklarohen se i kanë të përbashkëta, apo veçmas, sipas rastit. Në rastin konkret, subjekti ka pretenduar¹³ që pasuria e znj. A.O. nuk është në kuptimin formal pasuri, por është në fakt rrjedhojë e kontributit të drejtpërdrejtë të znj. A.O. dhe të familjarëve të saj, kontributit tim në cilësinë qoftë si prind, qoftë si bashkëjetues, dhe znj. A.O. ka pasur mundësi objektive që të gjitha të ardhurat që merrte nga paga t'i konservonte. Subjekti nuk e ka mohuar kontributin e tij në vënien e pasurisë prej znj. A.O., madje ka deklaruar që edhe të ardhurat e përfituara nga një kredi konsumatore në vlerën 1.000.000 lekë në mars të vitit 2007, ia ka vënë asaj në dispozicion, sepse kishte nevojë. Bazuar në këto deklarime të subjektit, arrijmë në konkluzionin se përcaktimi i momentit të fillimit të bashkëjetesës, në rastin konkret, shërben vetëm për të përcaktuar sasinë e kontributit që ka dhënë subjekti i rivlerësimit

¹² Periudhat e qëndrimit të znj. A.O. në ShBA para vitit 2012 variojnë nga 11 ditë periudha më e shkurtër deri në 119 ditë periudha më e gjatë, ndërsa pas vitit 2012 periudha më e shkurtër është 22 ditë dhe më e gjata 211 ditë.

¹³ Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore, datë 26.07.2018, dhe shpjegimeve të dhëna gjatë gjithë procesit të rivlerësimit në Komision.

për rritjen e fëmijës në periudhën objekt shqyrtimi, duke i krijuar bashkëjetueses mundësi për krijimin e pasurisë së saj, të regjistruar veçmas. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se faktet dhe rrethanat e analizuara më sipër, krijojnë bindjen se subjekti dhe znj. A.O. kanë filluar bashkëjetesën që nga viti 2004. Këto fakte përputhen me përkufizimin e bashkëjetesës së dhënë nga Kodi i Familjes, në nenin 163: *Bashkëjetesa është një bashkim fakti i burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie*. Edhe në rastin konkret, për subjektin u provua jetesa e përbashkët me personin e lidhur, me karakter stabiliteti, nga e cila kanë lindur edhe tre fëmijë.

50. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka konkluduar mbi faktin e bashkëjetesës së tij me znj. A.O. në vitin 2004, duke marrë *de facto* dhe *de jure* kompetencat e organeve që kanë tagrin e konstituimit të institutit të martesës apo bashkëjetesës, siç janë zyrat e gjendjes civile pranë bashkive, në tejkalim të tagrave që i jep ligji nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, bazuar në analizën e drejtë të fakteve, ka arritur në përfundimin se bashkëjetesa ka filluar në vitin 2004, me qëllimin e vetëm përlllogaritjen e drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve të znj. A.O. dhe subjektit të rivlerësimit. Komisioni nuk ka marrë kompetencat e organeve që kanë tagrin e konstituimit të martesës, sepse në rastin konkret nuk flitet për martesë, por as atë të bashkëjetesës, pasi kjo e fundit nuk regjistrohet në regjistrat e gjendjes civile dhe nuk ka ndonjë organ të posaçëm që e certifikon këtë gjendje fakti.
51. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka cenuar parimin e sigurisë juridike, duke përdorur në vendim termin “regjim pasuror veçmas”, i cili nuk parashikohet nga legjislacioni, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, në faqen 31 ka arsyetuar se nuk u provua pretendimi i subjektit lidhur me regjimin pasuror veçmas. Në seancën dëgjimore në Komision, subjekti është shprehur se bashkëjetesa e tij me znj. A.O. është në bazë të neneve 163 dhe 164 të Kodit të Familjes, veçse në aspektin formal mungon një deklaratë noteriale nga ana e tyre. Trupi gjykues vlerëson se referuar nenit 164 të Kodit të Familjes¹⁴, bashkëjetuesit nëse vendosin të ndajnë kufijtë e shpenzimeve dhe fitimeve, mund të lidhin marrëveshjen noteriale, e cila i detajon dhe i përcakton këto ndarje gjatë jetesës së përbashkët. Në rastin konkret, subjekti ka deklaruar¹⁵ se një marrëveshje e tillë për ndarjen e detyrimeve dhe fitimeve gjatë bashkëjetesës nuk ekziston, prandaj mund të deduktohet në mënyrë objektive dhe logjike, që nga një marrëdhënie bashkëjetese, nga e cila kanë lindur tre fëmijë, kontributi i secilit nga bashkëjetuesit të ketë qenë i barabartë. Në këtë këndvështrim, merr kuptim edhe arsyetimi i Komisionit se “regjimi pasuror veçmas nuk u provua”. Nga leximi tërësor i arsyetimit të Komisionit, duket se qëllimi i shprehjes së sipërcituar ka qenë vënia në dukje e faktit të mungesës së marrëveshjes noteriale mes bashkëjetuesve, në kuptim të nenit 164 të Kodit të Familjes, pasi faktin që znj. A.O. ka pasuri të regjistruara veçmas, Komisioni e ka bërë të qartë në vendimin e tij, për rrjedhojë përdorimi i shprehjes se “regjimi pasuror veçmas nuk u provua”, nuk ka sjellë asnjë pasojë për procesin e rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

52. *Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka konkluduar që bashkëjetuesja e tij, znj. A.O., ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, duke kryer një analizë financiare të padrejtë, e cila nuk pasqyron në mënyrë korrekte të ardhurat e saj. Komisioni, në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencë, ka anashkaluar vlerësimin dhe analizimin*

¹⁴ Në nenin 164 të Kodit të Familjes parashikohet: “Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës”.

¹⁵ Në seancën dëgjimore të datës 26.07.2018.

e dy dokumenteve shkencore, siç janë raportet e veçanta të audituesit ligjor, depozituar nga subjekti në datat 22.06.2018 dhe 04.07.2018. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka llogaritur të gjitha të ardhurat e pretenduara nga znj. A.O., me përjashtim të përfitimeve nga të ardhurat e raporteve mjekësore, në të cilat nuk ka marrë në konsideratë vlerën korresponduese prej 25396 lekësh për periudhën 01.05.2007 - 06.07.2007. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se Komisioni, vlerën prej 38500 USD, dhënë znj. A.O. nga motra e saj znj. A. O. në vitin 2007, e ka llogaritur me kursin e datës 31 dhjetor 2008 në vlerën 3196655 lekë. Trupi gjykues vlerëson se vlera prej 38500 USD duhej konvertuar me kursin e datës së kryerjes së transaksioneve bankare, për rrjedhojë duhet të ishte llogaritur në vlerën 3515747 lekë. Për sa i përket pretendimit të subjektit se në të ardhurat e znj. A.O. nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga punësimi i saj në universitetin “{***}”, në shumën 17.100 lekë, trupi gjykues, nga verifikimi i të dhënave të tabelës nr. 1 të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, konstaton se kjo vlerë është përlllogaritur në të ardhurat e znj. A.O..

53. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni padrejhtësisht ka injoruar në përlllogaritjen e të ardhurave ekzistencën e vlerave monetare në depozitat në emër të znj. A.O. dhe që janë tërhequr prej saj për efekt të hyrjes në marrëdhënie kontraktore, trupi gjykues konstaton se bashkëjetuesja e subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka deklaruar burimet e krijimit të pasurive të saj. Subjekti, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, ka deklaruar si burim krijimi të pasurive të bashkëjetueses vetëm depozitat e krijuara para viteve 2000 në vlerën 757.107 lekë, ndërsa për depozitat e krijuara pas këtyre viteve ka pretenduar vetëm të ardhurat e përfituara nga interesat e tyre. Për sa i përket destinacionit të depozitave në shumat 24.500 USD dhe 9.500 USD pranë Alpha Bank në emër të znj. A.O., të depozituara dhe të tërhequra brenda vitit 2006, znj. A.O. ka sqaruar se tërheqja dhe depozitimi/ridepozitimi i tyre është kryer në varësi të nevojave të saj apo të nevojave reciproke të pjesëtarëve të familjes së saj. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, pasi është njohur me rezultatin e hetimit se bashkëjetuesja nuk justifikonte burimin e krijimit të pasurive të paluajtshme, subjekti, në ndryshim me qëndrimin e mbajtur në deklaratimet e mëparshme gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se si burim krijimi të pasurive kanë shërbyer edhe tërheqjet nga llogaritë e depozitave të kursimeve të znj. A.O., qëndrim i mbajtur edhe në ankim. Trupi gjykues vlerëson se është i drejtë arsyetimi i Komisionit, pasi depozitat e krijuara nga znj. A.O. si përpara vitit 2000 edhe pas këtij viti, janë tërhequr duke filluar nga viti 2000 e deri në vitin 2006, pra të paktën një vit përpara datës së lidhjes së kontratës së parë të sipërmarrjes¹⁶. Për shumat e tërhequra, duke filluar që nga shuma prej 757.107 lekësh, e tërhequr nga Banka e Kursimeve, sipas mandatshlyerjes së depozitës në datën 01.08.2000 në emër të A. O. e deri te shuma prej 34.000 USD, e tërhequr më datë 07.02.2006 dhe 17.02.2006 nga Alpha Bank nga A.O., transaksione të vërtetuara sipas dokumentacionit bankar të administruar gjatë hetimit administrativ, mbështetur edhe në deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk arrin të krijojë bindjen se destinacioni i përdorimit të tyre është krijimi i pasurive të paluajtshme të znj. A.O.. Trupi gjykues përlllogariti mundësinë e familjes O. për të krijuar depozitat në emër të anëtarëve të saj, përfshirë edhe bashkëjetuesen e subjektit A.O., në vite, me qëllim për të vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Bazuar në këto përlllogaritje, trupi gjykues arriti në konkluzionin se familja O., me të ardhurat e krijuara në periudhën tetor 1991 - dhjetor 2008, nuk ka pasur mundësi të krijojë këto depozita me burime të ligjshme.

¹⁶ Kontrata e sipërmarrjes e lidhur më datë 01.03.2007.

54. Trupi gjykues konstaton se bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të paraqitura në Komision më datë 18.07.2018, subjekti ka paraqitur kërkesë për marrje/administrim provash të reja, ndër të cilat gjendet edhe raporti i veçantë i audituesit ligjor i datës 22.06.2018 dhe raporti i veçantë shtesë i audituesit ligjor i datës 04.07.2018, të cilët janë administruar nga Komisioni. Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar të subjektit, Komisioni në vendimin e datës 23.07.2018 arsyeton se ka refuzuar vetëm kërkimin e thirrjes së dëshmitarëve. Trupi gjykues konstaton se subjekti, shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ i ka bazuar tërësisht në rezultatet e raporteve të audituesit ligjor, duke i bërë pjesë të argumenteve për përllogaritjen e të ardhurave, shpenzimeve dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në shqyrtimin e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të paraqitura nga subjekti, ka shqyrtuar edhe rezultatet e raporteve audituese si pjesë përbërëse e tyre.
- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.***
55. *Subjekti ka pretenduar se Komisioni në vlerësimin e burimeve financiare të ligjshme të znj. A.O. nuk ka marrë në konsideratë, në mënyrë të padrejtë, të ardhurat e personave të saj të lidhur, brenda trungut familjar. Konkluzioni i Komisionit për mungesën e aftësisë pagueuse të prindërve të znj. A.O. është haptazi i pabazuar dhe në shkelje flagrante të ligjit, pasi nuk ka marrë në konsideratë ekzistencën dhe gjendjen e llogarive bankare të personave të lidhur të znj. A.O., të cilat datojnë që para vitit 2000, kohë kur subjekti i rivlerësimit ishte ende student.* Trupi gjykues konstaton se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij, gjatë hetimit administrativ në Komision, si burim krijimi të pasurive të saj të paluajtshme kanë deklaruar ndër të tjera edhe kontributin dhe ndihmën financiare nga prindërit e saj. Znj. A.O. ka deklaruar se burimet financiare të prindërve të saj kanë qenë të ardhurat nga pagat ndër vite, pensionet, interesat nga depozitat pas vitit 1990 e në vijim, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të luajtshme e të paluajtshme. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se prindërit e znj. A.O. kanë pasur depozita bankare të shumta, në të cilat ka pasur shumë veprime tërheqjeje në llogaritë bankare në periudhën 2005-2008.
56. Me qëllim vërtetimit të kontributit dhe ndihmës së prindërve të bashkëjetueses, subjekti ka paraqitur gjatë hetimit në Komision, deklaratën noteriale të datës 29.01.2018, të znj. L.O. para noterit të shtetit të Nju Jorkut, e legalizuar me *apostille*, në të cilën ajo ka deklaruar se bashkë me bashkëshortin e saj kanë ndihmuar financiarisht vajzën e tyre A.O., duke i dhënë shuma të ndryshme parash sipas nevojave të saj, për blerjen e pasurive të paluajtshme në rrugën “{***}”. Këto burime financiare ata i kanë siguruar nga kursimet familjare nga pagat, interesat e depozitave që nga viti 1996 dhe nga shitja e pasurive të luajtshme e të paluajtshme. Në analizë të kësaj deklarate, trupi gjykues konstaton se znj. L.O. nuk përcakton vlerën e ndihmës financiare dhënë znj. A.O. dhe nuk pretendon se paratë që ajo dhe bashkëshorti i kanë dhënë vajzës së tyre, vijnë nga tërheqja e depozitave në emër të tyre.
- Subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur një deklaratë të re noteriale të znj. L. O., të datës 13.07.2018, para noterit publik të shtetit të Nju Jorkut, në të cilën ajo deklaroi se kontributi total financiar për vajzën e tyre është rreth vlerës prej 50000 eurosh, dhënë znj. A.O. sipas nevojës dhe kërkesës së saj. Kjo deklaratë noteriale nuk është e legalizuar me *apostille* dhe, si të tillë, trupi gjykues nuk e konsideron me vlerë provuese në këtë gjykim.¹⁷
57. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit se prindërit e znj. A.O. kanë kontribuar në krijimin e pasurive të saj të paluajtshme, nuk janë

¹⁷ Bazuar në Konventën e Hagës së 5 tetorit 1961, e ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr.9060, datë 8.5.2003, “apostille” vërteton autenticitetin e firmës dhe cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka firmosur dokumentin.

shoqëruar me dokumentacion mbështetës për të provuar dhënien/dhurimin e kontributeve në periudhën e krijimit të pasurive në vitet 2007-2008, por duke mbajtur në konsideratë faktin se znj. A.O. nuk ka qenë subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar”), ajo nuk kishte detyrim që të faktonte me dokumentacion të kohës dhënien e këtyre kontributeve.

58. Bazuar në deklaratimet e znj. A.O. se ka jetuar me familjen e origjinës, vërtetuar me të dhënat e certifikatës familjare, si dhe në faktin se subjekti ka deklaruar në deklaratimet e pasurisë si adresa banimi ato të familjarëve të znj. A.O., trupi gjykues çmon se në analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e znj. A.O. për të krijuar pasuritë e saj të paluajtshme, duhet të konsiderohen të ardhurat e subjektit nga viti 2004 e në vijim, të ardhurat e znj. A.O. dhe të familjarëve të saj, si dhe shpenzimet e kryera prej tyre. Gjithashtu, vlerësimi dhe analizimi i plotë i mundësisë së familjarëve të znj. A.O., që me të ardhurat e tyre të krijojnë pasuritë e tyre dhe ato të znj. A.O. për periudhën 1991-2008, është kryer nga trupi gjykues, bazuar edhe në pretendimin e vazhdueshëm të subjektit të rivlerësimit për konsiderimin e kontributit të tyre, si gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu edhe në ankim.
59. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka përllogaritur në të ardhurat e familjes O. ato të ardhura të përfituara nga z. Rr.O. në ushtrimin e profesionit si avokat. Nga verifikimi i të ardhurave të pasqyruara në tabelën nr. 4 të vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në të ardhurat e prindërve të znj. A.O. janë përfshirë të ardhurat e z. Rr. O. nga aktiviteti i tij si avokat. Në analizë të pretendimit të subjektit, trupi gjykues, në shqyrtim të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se për të vërtetuar ushtrimin e aktivitetit si avokat nga z. Rr.O., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vendime gjyqësore, prokura të posaçme apo kontrata përfaqësimi të tij për individë/subjekte të ndryshme, pagesa të kryera në favor të tij nga subjekte të ndryshme, ndër vite, por nuk ka paraqitur një vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për të provuar se z. Rr.O. e ka ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje nga viti 1991 e deri në vitin 2016, apo lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit nga z. Rr. O. për këtë periudhë. Duke qenë se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij pretendojnë që prindërit e saj kanë kontribuar në krijimin e pasurive të regjistruara në emër të saj duke i dhënë shuma të hollash, bazuar në nenin 3, pika 14 dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se prindërit e znj. A.O. konsiderohen si persona të tjerë të lidhur me të dhe për këtë arsye kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument vërtetues të regjistrimit në organet tatimore për të provuar burimin e ligjshëm dhe pagimin e detyrimeve tatimore nga z. Rr.O., në cilësinë e avokatit, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë pamundësinë objektive për të siguruar një dokumentacion të tillë, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Mbështetur në faktet si më sipër, në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e z. Rr.O. nga ushtrimi i aktivitetit si avokat nuk duhet të përllogariteshin si të ardhura të ligjshme, nga Komisioni, për rrjedhojë, konsiderimi i tyre është bërë në interpretim të gabuar të ligjit.
60. Në lidhje me pretendimin e subjektit se z. Rr.O. ka përfituar të ardhura nga Banka e Kursimeve për efekt të zbatimit të urdhrave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përkatësisht në vitin 2000, në vlerën 1033261 lekë dhe në vitin 2002, në vlerën 409132 lekë, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka konsideruar në përllogaritjet e analizës financiare vetëm vlerën prej 409132 lekësh. Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, me qëllim vërtetimin e pagesës së këtyre shumave, nuk është i plotë, pasi ai nuk ka paraqitur asnjë

dokumentacion financiar që të vërtetojë pagesën e këtyre vlerave dhe as vendimet gjyqësore në ekzekutim të të cilave pretendohet se do të përfitoheshin këto shuma. Subjekti nuk ka provuar se është në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të siguruar bazën dokumentare justifikuese të përfitimit të vlerave të sipërcituara. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit justifikues, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vlerat prej 1 033 261 lekësh dhe 409.132 lekësh, nuk provohen si të përfituara nga z. Rr.O..

61. Subjekti pretendon se Komisioni në përlllogaritjet e tij nuk ka përfshirë të ardhurat e z. Rr.O. nga përfitimi i pensionit suplementar. Trupi gjykues, nga verifikimi i tabelës nr. 4 të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, konstaton se deri në fund të vitit 2008 Komisioni ka përfshirë të ardhura nga pensioni suplementar për z. Rr.O. në vlerën 551.629 lekë, ndërkohë që ky pension, bazuar në vërtetimin nr. {***}, datë 28.3.2018, të ISSh-së, Tiranë, i administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi t'i përkasë periudhës 01.07.2009 - 03.03.2018, në vlerën 899.738 lekë. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se Komisioni nuk duhet të kishte përlllogaritur në të ardhurat e z. Rr.O. vlera që u përkasin përfitimeve nga pensioni suplementar, pasi ato janë përfituar nga ai jashtë periudhës së analizës financiare.
62. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka përlllogaritur si të ardhura të znj. A.O. shumat e derdhura nga znj. D. K.Ç., si kthim borxhi, megjithëse ato janë vërtetuar me deklaratë noteriale dhe me dokumentacion bankar, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit, trupi gjykues konstaton se sipas dokumentacionit bankar të përcjellë në Komision nga Emporiki Bank, znj. D.K.Ç ka kaluar në llogarinë bankare të znj. A.O. në periudhën korrik 2006 - mars 2007 vlerën prej 4901 eurosh dhe 2091 USD, shuma të tërhequra nga znj. A.O. në mars 2007 dhe mars 2008. Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të znj. D.K.Ç., datë 17.07.2018, para noterit publik në Izrael, në të cilën ajo deklaroi se i ka kaluar znj. A.O. në rrugë bankare shumën prej 4900 eurosh dhe 2150 USD, në periudhën korrik 2006 deri në janar 2009, të cilën ia kishte marrë borxh prindërve të saj. Subjekti nuk ka shpjeguar arsyen pse këtë shumë të marrë borxh, znj. D.K.Ç nuk ia ka kthyer prindërve të znj. A.O., pasi ata dispononin llogari bankare personale. Deklarata noteriale e znj. D.K.Ç. nuk është e legalizuar me *apostille*, për rrjedhojë, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë faktin që subjekti si gjyqtar është në dijeni të kriterëve formale që duhet të plotësojë një akt/dokument i përpiluar në një vend të huaj, për t'u përdorur në cilësinë e provës në një gjykatë në Shqipëri, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjtit, nuk i jep vlerë provuese në këtë gjykim. Bazuar në situatën faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se gjatë hetimit në Komision nuk ka rezultuar e provuar arsyeja e kalimit të këtyre shumave në favor të znj. A.O., për rrjedhojë nuk e konsideron atë në përlllogaritjen e të ardhurave të bashkëjetueses së subjektit, znj. A.O..

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

63. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka konkluduar që bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, duke mos marrë në konsideratë, në mënyrë të padrejtë, të ardhurat e personave të trungut të subjektit të rivlerësimi (prindërve dhe vëllait të tij), të cilat për shkak të lindjes së fëmijës së subjektit të rivlerësimi, nuk ka asnjë pengesë që të përfshihen në të ardhurat e znj. A.O.. Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit, konstaton se babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimi kanë punuar në Kutalli, Berat, deri në vitin 2012¹⁸, kohë kur kanë përfituar pensionin e pleqërisë, ndërsa nga viti 2012 kanë jetuar me qira në Tiranë, bazuar në kontratën e

¹⁸ Vërtetim nga ISSh nr. {***} prot., datë 24.01.2017, për A. A. - pensioni fillon 24.04.2012.
Vërtetim nga ISSh nr. {***} prot., datë 25.10.2016, për N. A. - pensioni fillon 01.05.2012.

qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.07.2012, paraqitur nga subjekti bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit. Ata kanë pasur llogari depozitash në bankën “Raiffeisen”, babai i subjektit që nga viti 2008 dhe nëna që nga viti 2010, siç vërtetohet nga dokumentacioni bankar i administruar gjatë hetimit në Komision. Vëllai i subjektit të rivlerësimit ka filluar marrëdhëniet e punës më datë 17.12.2006, siç vërtetohet nga vërtetimi nr. {***} prot., datë 24.10.2016, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit në Komision. Subjekti i rivlerësimit ka jetuar dhe punuar në Tiranë, duke mos bashkëjetuar me personat e trungut të tij familjar. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se të afërmit e tij kanë kontribuar me të gjithë të ardhurat e tyre në rritjen e fëmijës R. A., duke lehtësuar shpenzimet e znj. A.O., nuk qëndron, pasi minimalisht të afërmit e tij me të ardhurat e krijuara nga puna e tyre do të duhet të përballonin shpenzimet e veta të jetesës, pagesat e detyrimeve, si dhe krijimin e depozitave bankare. Subjekti nuk ka arritur të provojë se sa është vlera e dhënë nga të afërmit e tij si kontribut për rritjen e nipit të tyre. Në deklaratën e lëshuar nga prindërit e subjektit, N. dhe A. Abdullahi, më datë 10.07.2018, deklaratë e panoterizuar, ata shprehën se kanë ndihmuar znj. A.O. dhe djalin e tyre B. Abdullahi, herë pas here me të holla, kur ata e kanë pasur të nevojshme, si dhe në kompensim të shpenzimeve për jetesë të nipërve të tyre, pa shprehur se sa ka qenë vlera e saktë e kontributit të tyre të dhënë për nipërit. Nga verifikimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit në vite, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar ndihmë apo kontribut financiar të dhënë nga prindërit e tij, drejtuar fëmijëve të tij. Trupi gjykues vlerësoi mundësinë financiare të prindërve të subjektit për të kontribuar në rritjen e fëmijës/fëmijëve të tij, duke arritur në konkluzionin se kontributi që ata mund të jepnin për të ndihmuar subjektin në rritjen e fëmijëve është në vlerën rreth 11032 lekë në vit ose rreth 919 lekë në muaj, pra në vlera të papërfillshme. Për këto arsye, si edhe për faktin se vullneti i deklaruesve nuk është shprehur para noterit publik, trupi gjykues, deklaratës së prindërve të subjektit, nuk i jep vlerë provuese në këtë gjykim.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

64. *Subjekti ka pretenduar se Komisioni në analizën financiare, në kundërshtim me provat e administruara, ka ekzagjeruar padrejtësisht shpenzimet e jetesës për znj. A.O., duke mos marrë në konsideratë faktin se ajo ka jetuar me familjarët e trungut të origjinës dhe ka pasur ndihmë financiare nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prindit të fëmijës, si dhe prindërit e tij në cilësinë e gjyshërve. Analiza financiare është jotransparente dhe jologjike, pasi në vendim nuk jepet asnjë informacion mbi metodologjinë e përdorur në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, si dhe ato janë ekzagjeruar, në një kohë kur standardi i jetesës para vitit 2008 ka qenë i ulët. Analiza financiare nuk është e saktë, pasi në vendim është llogaritur shuma 5066.650 lekë si shpenzime jetese për znj. A.O., ndërsa në rezultatet e hetimit administrativ i është llogaritur një shumë më e vogël, në vlerën 3186.193 lekë. Trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, faqe 21 dhe 22 konstaton se në tabelat e analizës financiare Komisioni ka pasqyruar vlerën 5066.650 lekë si shpenzime jetese, për periudhën 1999-2008 për subjektin e rivlerësimit, bashkëjetuesen e tij dhe fëmijën e tyre, duke konsideruar se ata e kanë nisur bashkëjetesën¹⁹ në vitin 2004. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës në vlerën 3186.193 lekë, vetëm për bashkëjetuesen e subjektit dhe për fëmijën e saj, për periudhën 2005-2008. Trupi gjykues vlerëson se kjo mënyrë analize e bërë në vendim, pasi Komisioni është njohur me shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe pretendimet e tij në seancë dëgjimore, shpjegon diferencën në vlerën e shpenzimeve mes arsyetimit të vendimit dhe*

¹⁹ Ashtu siç është arsyetuar në paragrafin 20.2 të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018.

rezultateve të hetimit administrativ. Trupi gjykues konstaton se, në faqen 9 dhe në faqen 23 të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, Komisioni ka shpjeguar mënyrën se si janë përlllogaritur shpenzimet e jetesës, duke marrë në konsideratë vlerën e shpenzimeve të jetesës për periudhën 2003-2008 sipas ILDKPKI-së, e cila është bazuar tek INSTAT, duke marrë në konsideratë dhe kontributin e bashkëjetueses për rritjen e fëmijës për periudhën 2005-2008, ndërsa për periudhën 2002-2003 bashkëjetuesja e subjektit ka jetuar në ShBA dhe shpenzimet minimale për konsum personal janë llogaritur në vlerën 600 USD në muaj; për periudhën 1999-2001 janë llogaritur shpenzime minimale për konsum në vlerën 5000 lekë në muaj për person. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur nga Komisioni, sipas raportit të ILDKPKI-së, i cili bazohet në të dhënat zyrtare të INSTAT-it dhe nuk është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se shpenzimet e jetesës së znj. A.O. janë përlllogaritur në vlera minimale.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

65. *Subjekti pretendon se në analizën financiare të Komisionit, në kundërshtim me provat e administruara, në shpenzimet e udhëtimit znj. A.O. i janë llogaritur shpenzime për udhëtime që ajo i ka kryer për shkak të punës, si dhe shpenzime për udhëtimet private, por që i janë paguar nga familjarët e vet. Analiza financiare nuk është e saktë, pasi në vendim është llogaritur shuma 815.797 lekë si shpenzime udhëtimi për znj. A.O., ndërsa në rezultatet e hetimit administrativ i është llogaritur një shumë më e vogël, në vlerën 530.768 lekë. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, faqe 21 dhe 22 konstaton se në tabelat përkatëse, Komisioni ka pasqyruar vlerën 815.797 lekë si shpenzime udhëtimi për periudhën 1999-2008 për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesen e tij, duke konsideruar se ata e kanë nisur bashkëjetesën në vitin 2004. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit në vlerën 530.768 lekë, vetëm për bashkëjetuesen e subjektit. Trupi gjykues vlerëson se analiza e kryer në vendim, pasi Komisioni është njohur me shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe pretendimet e tij në seancë dëgjimore, shpjegon diferencën në vlerën e shpenzimeve të udhëtimit mes arsyetimit të vendimit dhe rezultateve të hetimit administrativ.*
66. *Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka shpjeguar se për udhëtimet vajtje-ardhje të bashkëjetueses së subjektit në ShBA janë marrë në konsideratë vetëm kostot e biletave, duke përjashtuar rastet e deklaruara prej saj se janë mbuluar nga familjarët. Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit, trupi gjykues konstaton se për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur kopje biletash udhëtimi të znj. A.O., të prenotuara dhe të paguara nga e motra, rezidente në ShBA, për periudha të ndryshme në vitet 2006, 2011, 2012, 2013. Subjekti ka paraqitur gjithashtu deklaratë noteriale të znj. A.O., redaktuar nga noteri publik i shtetit të Nju Jorkut, datë 29.01.2018, e legalizuar me *apostille*, në të cilën ajo deklaroi mbështetjen financiare për motrën e saj. Duke i vlerësuar në harmoni këto akte, trupi gjykues krijon bindjen se për periudhën 2005-2008, shpenzimet e udhëtimit të znj. A.O. drejt ShBA-së dhe në kthim, provohet se janë paguar nga motra e saj A.O.. Për këtë arsye, Komisioni duhet t'i kishte zbritur nga shpenzimet totale të udhëtimit.*
67. *Subjekti pretendon se në shpenzimet e udhëtimit të znj. A.O. janë përlllogaritur dhe shpenzimet për një udhëtim që ajo ka kryer nga puna si eksperte ligjore në Komitetin e MONEYVAL, si dhe tri udhëtime të subjektit që ai i ka kryer një për shkak pune dhe dy në vendet fqinje. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, konstaton se ai nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të vërtetuar se njëri nga udhëtimet e kryera prej tij ka qenë për arsye pune. Ndërsa dy udhëtimet e tjera, siç referon*

dhe vetë subjekti se kanë qenë në vendet fqinje, janë udhëtime private të tij, për këtë arsye trupi gjykues vlerëson se është e drejtë llogaritja nga Komisioni e shpenzimeve të kryera nga subjekti, për to. Për sa i përket pretendimit të subjektit se znj. A.O. i janë llogaritur shpenzimet e udhëtimit për një udhëtim pune në dhjetor të vitit 2008, bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur faqen e parë të raportit të mbledhjes plenare të MONEYVAL, Strasburg 8-12 dhjetor 2008 dhe një listë pjesëmarrësish, në të cilën figuron znj. A.O. si përfaqësuese e shtetit shqiptar. Subjekti nuk ka sqaruar se cila është origjina/burimi i këtij dokumentacioni, si dhe të dhëna për vijimësinë mes faqes së parë dhe të dytë të këtij dokumentacioni. Trupi gjykues vlerëson se, në mungesë të një konfirmimi zyrtar nga Ministria e Drejtësisë për të vërtetuar se znj. A.O. ka përfaqësuar shtetin shqiptar në atë konferencë e për pasojë shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga ky institucion, subjekti nuk ka arritur të provojë se shpenzimet e udhëtimit të znj. A.O. drejt Strasburgut nuk janë mbuluar nga ajo.

Për sa më sipër, pretendimi i subjektit është pjesërisht i bazuar, por nuk ndikon në konkluzionin përfundimtar të trupit gjykues.

68. *Subjekti pretendon se analiza financiare e Komisionit, padrejtësisht, ndalet/stopohet te pika e shumës së derdhur prej 131.500 eurosh deri në datën 26.09.2008, duke bërë kështu copëzimin e hetimit lidhur me vlerësimin e pasurisë së personit të lidhur, në një kohë kur znj. A.O. nuk ishte subjekt deklarimi dhe marrëdhënia kontraktore ishte ende e pafinalizuar e për më tepër kur pranohet nga znj. A.O. se në atë periudhë ajo nuk ishte pronarja e vetme e shumës së derdhur, pasi derdhje të shumës për llogari të vet ka bërë edhe babai i saj. Analiza financiare e Komisionit duhet të ishte shtrirë deri në vitin 2013, vit në të cilin është materializuar kontrata e shitjes, me qëllim përcaktimin objektiv dhe real të vlerës në total të pasurisë, ashtu siç është vepruar për subjekte të tjera rivlerësimi, për të cilat hetimi është zhvilluar i plotë dhe i shtrirë për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëjetuesja e subjektit, znj. A.O., ka deklaruar se disponon pasuri të paluajtshme, veçmas, të regjistruara në emrin e saj, si në vijim: apartament me sipërfaqe totale 118 m², me adresë rr. “{***}”, h. {*}, ap. {*}, Tiranë dhe garazh, me sipërfaqe totale 20 m² në rr. “{***}”, Tiranë, të regjistruar në ZVRPP, Tiranë, me vlerë përkatësisht 7.758.900 lekë dhe 14.500 euro, si dhe apartament me sipërfaqe 98,3 m², godina nr. {*}, Golem, në vlerën 50.000 euro.*
69. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues konstaton se pasurinë apartament me sipërfaqe totale 118 m² dhe garazh 20 m², znj. A.O. e ka fituar në bazë të kontratës së shkëmbimit për pasuritë e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2016, të lidhur mes saj dhe znj. A.O.²⁰. Këtë apartament znj. A.O. e ka fituar nga shkëmbimi me pasurinë apartament me sipërfaqe totale 66,60 m², i regjistruar në ZVRPP, Tiranë, me adresë rr. “{***}”, h. {*}, ap. {*}, Tiranë dhe pasurinë e llojit garazh në rrugën “{***}”, Tiranë. Për sa u përket pasurive të sipërcituara në ish-pronësi të znj. A.O., nga dokumentacioni i paraqitur nga ajo dhe nga subjekti, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, rezulton se më datë 01.03.2007, znj. A.O., në cilësinë e porositëses dhe shoqëria “{***}” ShPK në cilësinë e palës sipërmarrëse, kanë lidhur “Kontratë sipërmarrje” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2007. Objekt i kësaj kontrate është porositja e një apartamenti me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 74,2 m²; zyrë me sipërfaqe 30 m²; garazh në kuotën -5,95 m. Çmimi për apartamentin është caktuar 1.200 euro/m² në vlerën totale 89.040 euro; për zyrën 2.800 euro/m² në vlerën totale 84.000 euro; për garazhin në vlerën totale 19.000 euro. Në total, të tria ambientet së bashku do të kushtonin 192.040 euro. Në datën 26.09.2008, znj. A.O. dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë lidhur

²⁰ Znj. A. O. është e motra e znj. A. O., bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit.

shtesë kontrate sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.09.2008, sipas së cilës nga çmimi në total prej 192.040 eurosh, i caktuar për ambientet e porositura, deri në datën e lidhjes së kësaj shtese kontrate, është paguar shuma 131.500 euro. Meqenëse nga tri ambientet e porositura znj. A.O. ka mbajtur vetëm apartamentin dhe garazhin, atëherë mes palëve është rënë dakord që shuma totale e dy ambienteve të jetë 101.500 euro dhe shoqëria do t'i kthente znj. A.O. shumën prej 30.000 eurosh. Palët kanë revokuar kontratën e sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2007, për sa i përket ambientit zyrë me sipërfaqe 30 m². Më datë 10.06.2013, znj. A.O. dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë nënshkruar “Akt rakordimi”, në të cilin kanë deklaruar se duke qenë se pala sipërmarrëse nuk ka përbushur në kohë dhe me cilësi porosinë e bërë nga znj. A.O., nga palët kontraktore është rënë dakord që çmimi përfundimtar i shitjes së pasurive objekt kontrate të jetë 7.758.900 lekë për apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme 74 m², nga të cilat 66,65 m² sipërfaqe banimi dhe 7,6 m² sipërfaqe e përbashkët dhe 14.500 euro për garazhin e ndodhur në kuotën -5,95 m. Pala sipërmarrëse ka deklaruar se e ka arkëtuar të plotë çmimin e shitjes së apartamentit dhe të garazhit. Më datë 10.10.2013, znj. A.O. në cilësinë e palës blerëse dhe z. P. F.²¹ e znj. A. F. në cilësinë e palës shitëse kanë lidhur “Kontratë shitblerje prone pasuri të paluajtshme njësi” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.10.2013, me objekt shitjen e një ambienti me sipërfaqe 66,60 m² që ndodhet në rr. “{***}”, në Tiranë. Referuar përmbajtjes së kontratës së sipërcituar, znj. A.O. ka likuiduar çmimin 7.758.900 lekë për pasurinë objekt kontrate, paraprakisht jashtë zyrës noteriale, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2007, dhe shtesë kontrate sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.09.2008. Ndërsa për garazhin, palët nuk kanë lidhur kontratë shitjeje, por sipas deklaratave të shoqërisë, përkatësisht më datë 28.03.2014 dhe 1.10.2016, çmimi i tij i likuiduar nga pala porositëse është 14.500 euro. Trupi gjykues konstaton se ky përcaktim kontraktor përputhet me sa kanë deklaruar palët në kontratat e mëparshme, pasi që në shtator 2008 znj. A.O., realisht, kishte likuiduar vlerën e apartamentit dhe garazhit, pasi kishte paguar një vlerë shumë më të madhe se sa ajo e rënë dakord në kontratën e shitjes.

70. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, znj. A.O., në lidhje me pagesën e kryer prej 131.500 eurosh deri në shtator 2008 dhe kthimin e shumave nga shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK, gjatë hetimit administrativ në Komision kanë pretenduar se kthimi i shumave pas rakordimit për efekt të ndryshimit të kushteve kontraktore është bërë në periudhën fundi i shtatorit - fillimi i tetorit 2008 dhe se kjo shumë është përdorur për hyrjen në kontratë porosie, më datë 15.10.2008, me shoqërinë “{***}” ShPK, për blerjen e një apartamenti në Golem. Subjekti, për të vërtetuar kthimin e shumës prej 30.000 eurosh nga shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK, ka paraqitur mandatpagesën nr. 312, datë 09.09.2008, paguar A. O., me përshkrimin “Për kthim shume 10.000 euro” nga “{***}”, i nënshkruar marrësi dhe vetëm firmosur nga arkëtari dhe mandatpagesën nr. 339, datë 24.09.2008, paguar A.O., me përshkrimin “Për kthim shume 20.000 euro” nga “{***}”, i nënshkruar marrësi dhe vetëm i sigluar nga arkëtari. Trupi gjykues, nga verifikimi i mandatpagesave të paraqitura nga subjekti, nëse ato përputhen me kërkesat ligjore të legjislacionit të kohës, përkatësisht nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikës 2.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, arrin në konkluzionin se këto mandatpagesa janë të parregullta, në kuptim të besueshmërisë së tyre, pasi nuk kanë të përcaktuar saktë emërtimin, formën juridike dhe adresën e njësisë ekonomike, nuk kanë të plotë tregimin e personit që ekzekuton veprimin, pasi është shënuar vetëm siglimi i arkëtarit dhe jo nënshkrimi i plotë, emër

²¹ Z. P. Fushaj është administratori i shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK.

mblidhetur i tij, si dhe mungon tregimi i personit ose i njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit. Për këtë arsye, nuk i konsideron mandatpagesat e sipërcituara si provë e vlefshme në këtë gjykim.

Trupi gjykues konstaton se shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK, në informacionin e përcjellë në Komision, në ndryshim nga sa ka deklaruar në kontratën e shitjes, lidhur me ndryshimin e çmimit përfundimtar në këtë kontratë, pranon se ky çmim paraprakisht është rikonfirmuar edhe në akt rakordimit të datës 10.06.2013 dhe veprimet mes palëve janë kryer po në të njëjtën periudhë kur është bërë dhe shtesa e kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.09.2008. Deklarimet e shoqërisë sipërmarrëse vijnë në kundërshtim me sa është deklaruar në shtesën e kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.09.2008, sipas së cilës çmimi për dy pasuritë nga 131.500 euro të paguara, u dakordësua në 101.500 euro dhe vlera prej 30.000 eurosh do t’i kthehej në të ardhmen znj. A.O., pa përcaktuar kohë kthimi. Kthimin e diferencës së çmimit mes vlerës 101.500 euro me çmimin 7758900 lekë për apartamentin dhe 14.500 euro për garazhin, as subjekti, as shoqëria “{***}” ShPK nuk e vërtetojnë me dokumentacion bazë financiar të kohës kur është kryer veprimi financiar.

71. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të nenit 660 të Kodit Civil, i cili përcakton: *Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi*, i lidhur ky me nenin 690 të po këtij Kodi: *Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët*, si dhe duke pasur në konsideratë se qëllimi i lidhjes së shtesës së kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.09.2008, ka qenë riformatimi i porosisë dhe çmimit të pasurive të porositura, kthimi i diferencës së çmimit mes vlerës 101.500 euro me çmimin 7758900 lekë + 14.500 euro nga shoqëria sipërmarrëse te znj. A.O. është kryer pas datës së lidhjes së aktit të rakordimit, datë 10.06.2013, ose pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes datë 10.10.2013, ku palët kanë shprehur vullnetin para noterit publik për dakordësimin e këtij çmimi. Në vijim të këtij argumenti, trupi gjykues çmon të theksojë se edhe vetë bashkëjetuesja e subjektit nuk ka mbajtur një qëndrim të qartë për kthimin e gjithë diferencës së çmimit brenda vitit 2008, por ajo është përpjekur të provojë se i është kthyer vetëm shuma prej 30.000 eurosh brenda kësaj periudhe. Nëse do të kishte marrë të plotë diferencën e çmimit nga shoqëria sipërmarrëse që në vitin 2008, atëherë znj. A.O. nuk do të kishte nevojë të përdorte si burim krijimi të pasurisë apartament me sipërfaqe 98,3 m², në Golem shumë më prej 38.500 USD, dhënë nga e motra. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, në arsyetimin e vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, ka pranuar kthimin e kësaj shume brenda tetorit 2008, duke e llogaritur atë si burim krijimi për pasurinë e dytë, apartament 98,3 m² në Golem. Trupi gjykues vlerëson se kthimi i kësaj shume brenda tetorit 2008 nuk provohet nga përcaktimet kontraktore të nënshkruara nga znj. A.O. dhe shoqëria sipërmarrëse e as me dokumentacion justifikues financiar. Pretendimi i subjektit se diferenca e çmimit mes vlerës 131.500 euro dhe vlerës së kontratës së shitjes i është kthyer znj. A.O. që në shtator të vitit 2008, nuk provohet nga dokumentacioni i dorëzuar prej tij.
72. Trupi gjykues çmon se analiza për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të znj. A.O. për kryerjen e pagesës prej 131.500 eurosh duhet të kryhet deri në datën 26.09.2008 dhe jo deri në fund të vitit 2008, siç ka vepruar Komisioni, pasi rezultoi e provuar se kjo shumë është paguar nga znj. A.O. deri në këtë datë. Znj. A.O. nuk ka kryer asnjë pagesë tjetër në favor të shoqërisë sipërmarrëse, pas datës 26.09.2008. Analiza financiare ka për qëllim të përcaktojë mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në kohën e kryerjes së pagesave. Për këtë arsye, kjo analizë nuk mund të kryhet e shtrirë deri në vitin 2013, si pretendon subjekti. Sipas kontratës së shitjes së datës 10.10.2013, znj. A.O. është bërë pronare e apartamentit 66,60 m² në këtë vit, por pagesa për krijimin e kësaj pasurie është kryer deri në 26.09.2008.

73. Në lidhje me pretendimin e subjektit se znj. A.O. nuk ka qenë pronare e vetme e kësaj shume, pasi i interesuar në porosi ka qenë dhe babai i saj, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, konstaton se kontrata e sipërmarrjes, shtesa e saj dhe akti i rakordimit janë akte të nënshkruara nga znj. A.O.. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, znj. A.O. ka paraqitur “Prokurë e posaçme”, datë 19.09.2013, e redaktuar nga noteri publik i shtetit të Nju Jorkut, ShBA, e legalizuar me *apostille*, sipas së cilës ajo emëron si përfaqësues të posaçëm babanë e saj, Rr. Osmanaj, të cilit i jep kompetenca të plota që në emër dhe për llogari të saj ta përfaqësojë në blerjen e apartamentit dhe garazhit në rr. “{***}”. Kontrata e shitblerjes së apartamentit dhe garazhit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.10.2013, është nënshkruar nga z. Rr.O. si përfaqësues i znj. A.O. dhe kjo pasuri është e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në emër të saj më datë 24.02.2014.
- Subjekti, gjatë hetimit administrativ, për të provuar pretendimin e tij se shuma prej 30.000 eurosh është kthyer nga shoqëria sipërmarrëse në shtator 2008 dhe i përkiste z. Rr.O., i cili më pas këtë shumë ia ka kaluar si kontribut financiar vajzës së tij, A. O., ka paraqitur deklaratë noteriale të znj. L. O., nëna e znj. A.O., datë 13.07.2018, para noterit publik të shtetit të Nju Jorkut. Trupi gjykues, bazuar në faktin se nuk u provua me dokumentacion mbështetës që shuma prej 30.000 eurosh i përkiste z. Rr.O. dhe se kjo deklaratë noteriale nuk është e legalizuar me *apostille*²², nuk e konsideron këtë dokument me vlerë provuese në këtë gjykim. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në marrëdhënie kontraktore me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK ka hyrë znj. A.O. dhe jo babai i saj.
74. Për sa i përket pasurisë apartament me sipërfaqe 98,3 m², godina nr. {*}, Golem, trupi gjykues konstaton se në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2008, e paraqitur nga bashkëjetuesja e subjektit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, znj. A.O., në cilësinë e porositesës dhe shoqëria “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit kanë deklaruar se vlera e apartamentit është 67.500 euro, nga e cila porositesja ka likuiduar shumën prej 50.000 eurosh dhe pjesa e mbetur prej 17.500 eurosh do të likuidohet jo më vonë se data 25.12.2008. Palët kanë rënë dakord që dorëzimi i apartamentit do të bëhej në fund të muajit dhjetor 2008, parashikim ky i lidhur me pagimin e plotë të çmimit brenda datës 25 dhjetor 2008, ndërsa çdo ndryshim i kësaj kontrate duhet të bëhej me shkrim, të firmosej nga palët dhe të vërtetohej nga noteri.
75. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit në lidhje me pagesën e shumës së mbetur prej 17.500 eurosh, subjekti dhe znj. A.O. kanë deklaruar se porosia nuk është përfunduar në kohë për shkaqe objektive dhe subjektive të shoqërisë ndërtuese dhe për këtë arsye ka ndërhyrë shteti nëpërmjet ALUIZNI-t për formalizimin e marrëdhënies.
- Trupi gjykues konstaton se sipas informacionit të dërguar në Komision nga ALUIZNI, shoqëria “{***}” ShPK i ka paraqitur kërkesë këtij institucioni më datë 06.10.2010, për legalizimin e disa prej apartamenteve të godinës nr. {*}, Golem, ndërsa për apartamentet e tjera të kësaj godine leja është kërkuar nga individë, ndërmjet të cilëve edhe porositesja A. O., e cila e ka paraqitur kërkesën më datë 07.10.2010. Në mungesë të një shpjegimi bindës të subjektit dhe bashkëjetueses së tij në lidhje me mospagimin e shumës prej 17.500 eurosh, në mungesë të një ndryshimi me akt noterial të kontratës së sipërmarrjes për sa i përket çmimit të apartamentit, si dhe mbështetur në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: *Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj*, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili

²² Sipas Konventës së Hagës së 5 tetorit 1961 e ratifikuar nga vendi ynë me ligj nr.9060, datë 8.5.2003.

përcakton: *Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre, trupi gjykues krijon bindjen se bashkëjetuesja e subjektit, deri në datën 25.12.2005, ka shlyer tërësisht detyrimin kontraktor prej 67.500 eurosh për blerjen e apartamentit 98,3 m², godina nr. {*}, Golem. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni nuk duhet të konsideronte në përlllogaritje në analizën financiare, vlerën prej 50.000 eurosh si vlerë të paguar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për blerjen e kësaj pasurie.*

76. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka përlllogaritur mundësinë e znj. A.O. për të justifikuar pagesën në vlerën 131.500 euro me burime të ligjshme financiare, duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e znj. A.O. dhe të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1997-2008. Trupi gjykues vlerëson se në përlllogaritjen e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk duhet të kishte përfshirë të ardhurat e përfituara nga ai në periudhën 1997-2003, pasi bashkëjetesa e tij me znj. A.O., Komisionit i ka rezultuar e provuar se ka filluar në vitin 2004 dhe subjekti në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 nuk ka deklaruar kursime. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer në datën 26.09.2008, në vlerën 9.625.850 lekë.
77. Trupi gjykues kreu analizën financiare, duke konsideruar se bashkëjetesa e subjektit me znj. A.O. ka filluar në vitin 2004, së bashku me familjen e saj, si dhe duke marrë në konsideratë pretendimin e subjektit se të afërmit e bashkëjetueses kanë kontribuar në krijimin e pasurive të saj. Në përlllogaritje u konsideruan të ardhurat dhe shpenzimet e bashkëjetueses, së bashku me të ardhurat dhe shpenzimet e familjes O., duke i shtuar në vitin 2004 të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit. Periudha e analizës shtrihet nga data 01.10.1991 - 26.09.2008, gjatë së cilës në të ardhurat e familjes O. janë përfshirë të ardhurat që burojnë nga pagat, pensionet, shitja e një njësie shërbimi (kioskë) dhe kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit. Në shpenzime janë përfshirë shpenzimet e jetesës, shpenzimet e udhëtimit, shlyerja e principalit dhe shpenzimet për interesa kredie, si dhe shpenzimet e familjes O. dhe bashkëjetueses së subjektit për blerje pasurie. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas standardit të përdorur nga Komisioni, sipas ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT. Përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve u krye mbështetur në arsyetimin e bërë në paragrafët 54-68 të këtij vendimi. Trupi gjykues evidenton se duke analizuar pretendimet e subjektit në dritën e rrethanave të reja, të ndryshme nga ato të analizës së kryer nga Komisioni, si dhe në korrigjim të disa përlllogaritjeve të kryera prej tij në vlerësim të fakteve, situata financiare e subjektit nuk përmirësohet, por mbetet negative, të paktën në vlerën e konkluduar nga Komisioni, duke mos justifikuar pagesën e kryer në datën 26.09.2008.
78. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka përlllogaritur mundësinë e znj. A.O. për të justifikuar blerjen e apartamentit me sipërfaqe 98,3 m², në Golem në vlerën 50.000 euro, me burime të ligjshme financiare, duke përfshirë në këtë analizë edhe blerjen e apartamentit 66,60 m² dhe garazhit në rrugën “{***}”, meqenëse pagesat për këto dy pasuri janë kryer në vitin 2008. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e dy pasurive, deri në dhjetor 2008, në vlerën 5.934.867 lekë. Trupi gjykues, bazuar në analizën e kryer prej tij në paragrafin 75 të këtij vendimi, mundësinë e bashkëjetueses së subjektit për të justifikuar blerjen e apartamentit 98,3 m² në Golem, e ka përlllogaritur në vijim të analizës për verifikimin e mundësisë së znj. A.O. për të kryer pagesën prej 131.500 eurosh për apartamentin dhe garazhin në rrugën “{***}”, duke e shtrirë analizën financiare pavarësisht akteve/dokumenteve të administruara për të dyja këto pasuri, deri në dhjetor

2008, pasi pagesat për të dyja pasuritë janë kryer gjatë vitit 2008. Në përlllogaritjen e të ardhurave është përfshirë edhe vlera prej 38.500 USD, dhënë znj. A.O. nga motra e saj, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet deri më 31 dhjetor 2008. Trupi gjykues evidenton se duke analizuar pretendimet e subjektit në dritën e rrethanave të pretenduara prej tij, të ndryshme nga ato të analizës së kryer nga Komisioni, situata financiare e tij mbetet negative, të paktën në vlerën e përlllogaritur nga Komisioni, me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat për të dyja pasuritë. Në këtë kontekst, trupi gjykues arrin në konkluzionin se është i drejtë përfundimi i Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 66,60 m² dhe garazh, me adresë rruga “{***}”, Tiranë, në ish-pronësi të bashkëjetueses, znj. A.O., dhe të pasurisë apartament me sipërfaqe 98,3 m², në Golem, Durrës, në pronësi të saj, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

79. *Subjekti ka pretenduar se Komisioni i ka lejuar vetes cenimin e parimit të proporcionalitetit, pasi nuk ka marrë në konsideratë faktin e provuar nga hetimi se subjekti i rivlerësimit e familjarët e tij dhe personi i lidhur e familjarët e vet kanë bërë një jete modeste. Komisioni, në kundërshtim me parimin e vlerësimit tërësor të procedurave, ka injoruar faktin se znj. A.O. në marrëdhëniet e saj kontraktore ka respektuar kërkesat e legjislacionit në shkallën më të lartë, pavarësisht se viti 2007 ka qenë një periudhë informaliteti. Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi, konstaton se Komisioni, në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi për pasuritë e krijuara prej tij ose nga familjarët e tij. Ndërsa për sa i përket personit të lidhur dhe familjarëve të saj, trupi gjykues konstaton se Komisioni, duke i përlllogaritur znj. A.O. dhe prindërve të saj shpenzime minimale jetese, ka konsideruar se ajo ka kryer një jetë modeste. Parimi i proporcionalitetit, i pretenduar nga subjekti si i shkelur nga Komisioni, nuk lidhet me rrethanat e rastit konkret, pasi qëllimi i procesit të rivlerësimit, nuk është vlerësimi nëse subjektet kanë bërë një jetesë modeste ose jo, por ata ngarkohen me përgjegjësi disiplinore, nëse sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose nëse nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka injoruar faktin se znj. A.O. në marrëdhëniet e saj kontraktore ka respektuar kërkesat e legjislacionit në shkallën më të lartë, pavarësisht se viti 2007 ka qenë një periudhë informaliteti, trupi gjykues vlerëson se znj. A.O. ka hyrë në marrëdhënie kontraktore në vitin 2007, duke nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje për të porositur/prenotuar tri pasuri të paluajtshme. Sipas nenit 659 të Kodit Civil, kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Në kuptim të këtij neni, por edhe të gjithë përmbajtjes së Pjesës V, Titulli I i këtij Kodi, palët hyjnë në marrëdhënie kontraktore për t’u kujdesur në mënyrën më të mirë të mundshme, për interesat e tyre, sidomos ato pasurore. Formalizimi i marrëdhënieve kontraktore nga ana e znj. A.O. nuk e shkarkon atë ose subjektin nga përgjegjësia për justifikimin e burimit të ligjshëm të pasurive.*

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

80. *Subjekti pretendon se Komisioni, përkundër parimit kushtetues, frymës së ligjit nr. 84/2016 për mosngarkimin me barrën e provës në rastin kur subjekti i rivlerësimit nuk ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka injoruar faktin se vetëm të ardhurat personale të znj. A.O. janë në masën 23.690.911 lekë, ndërsa vlera e pasurisë së saj është 16.327.900 lekë. Në këtë mënyrë, Komisioni ka rënë ndesh me vlerësimin e bërë nga institucioni i specializuar ILDKPKI, me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në çështjen për subjektin e rivlerësimit*

F. L., si dhe ka cenuar nenet 4 dhe 13 të Kodit të Procedurave Administrative. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, masën disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë nuk e ka bazuar në përcaktimet e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon dhënien e masës disiplinore në rastet kur rezulton se subjekti gjatë vlerësimit të pasurisë ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Vendimmarrjen e tij Komisioni e ka mbështetur në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklarim të pamjaftueshëm të subjektit sipas nenit 33 të këtij ligji. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës bazuar në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Për sa i përket pretendimit të subjektit se vlerësimi i Komisionit bie ndesh me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 3, datë 17.07.2018, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pambështetur në përmbajtjen e vendimit të cituar, në të cilin Kolegji gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, përfshirë dhe personat e lidhur me të.

Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

81. *Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për shkak se personat e lidhur të përmendur në certifikatën e tij familjare nuk kanë përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor për deklarim, nuk përbën provë të mjaftueshme, pasi kjo rrethanë ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit ligjor nga ILDKPKI-ja; dokumentacioni ekziston dhe është depozituar në një institucion legjitim si Kuvendi i Shqipërisë, si dhe në rastin konkret bëhet fjalë për persona jo në ngarkim, për pasojë detyrimi për deklarim nuk qëndron. Subjekti kërkon të thirret si dëshmitare specialistja e ILDKPKI-së, znj. E.D., e cila ka refuzuar të administrojë deklaratat e pasurisë së personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në analizë të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit dhe certifikatës familjare të subjektit të rivlerësimit të paraqitur bashkëlidhur saj, konstaton se subjekti nuk ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për personat e lidhur me të, nënën, babanë dhe vëllain e tij. Subjekti pretendon se ka dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë deklaratat e pasurisë së personave të lidhur, për shkak të kandidimit të tij për anëtar të KLGj-së dhe këtë fakt e provon me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, i cili i ka vënë në dispozicion subjektit të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në këtë institucion, bazuar në nenin 278 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, i administruar gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues konstaton se subjekti, deklaratat e pasurisë së personave të lidhur i ka paraqitur të ndara si deklaratat më vete dhe jo të bashkëlidhura me deklaratën e tij të pasurisë. Trupi gjykues vlerëson se subjekti, bazuar në nenin D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30, 31, pika 1 dhe 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin ligjor të plotësojë deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe ta dorëzojë atë pranë ILDKPKI-së. Deklarimi përfshin pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit dhe personave të lidhur, përfshirë interesat privatë, që i ka në pronësi, posedim ose në përdorim, në përputhje me ligjin. Persona të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, janë rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, për subjektin e rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit. Kur pasuria e personave të lidhur është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas*

dhe i bashkëlidhet deklaratës së subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, subjekti kishte detyrimin të dorëzonte bashkëlidhur me deklaratën e tij edhe atë të prindërve dhe të vëllait të tij, si persona të lidhur të përmendur në certifikatën e tij familjare. Detyrimi i këtyre personave për deklarim është i përcaktuar qartë në normat kushtetuese dhe ato të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk lidhet në asnjë rast me faktin e qenies apo jo në ngarkim të subjektit. Subjekti, pavarësisht se pretendon dhe provon se ka dorëzuar këto deklarata më datë 16.01.2017 në Kuvendin e Shqipërisë sipas ligjit nr. 115/2016, rezulton se procesin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit e ka kryer edhe pranë ILDKPKI-së, më datë 27.01.2017. Paraqitja e këtyre deklaratave në Kuvendin e Shqipërisë nuk e shkarkon subjektin nga detyrimi i dorëzimit të tyre edhe në ILDKPKI, sipas ligjit nr. 84/2016. Subjekti pranon se deklaratat e të afërmeve të tij i ka paraqitur edhe pranë ILDKPKI-së, por punonjësja e ngarkuar me inventarizimin e dokumentacionit nuk ia ka pranuar ato. Subjekti, në mungesë të dokumentacionit provues për këtë pretendim, i ka kërkuar Komisionit që të thirret si dëshmitare punonjësja e ILDKPKI-së, znj. E.D., kërkesë kjo e refuzuar nga Komisioni me vendimin e datës 23.07.2018. Për sa i përket kërkesës së subjektit që znj. E.D. të thirret nga Kolegji në cilësinë e dëshmitares, trupi gjykues vlerëson se udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, në pikën 3 përcakton qartë detyrimin e punonjësve të ILDKPKI-së në pranimin e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti nuk ka provuar se ka kryer ndonjë komunikim shkresor me institucionin e ILDKPKI-së për të kërkuar zbatimin korrekt të ligjit, apo qoftë edhe për të bërë ankesë kundrejt punonjësës, që sipas pretendimit të tij nuk zbatoi ligjin dhe udhëzimin në mënyrën e duhur e sidomos kur vetë shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016 përcakton në faqen 3 se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se thirrja e znj. E.D. në cilësinë e dëshmitares, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, duket se është e panevojshme, pasi nuk mund të pretendohet që znj. E.D. të kujtojë fakte që datojnë rreth dy vjet më parë, duke mbajtur në konsideratë këtu edhe numrin e madh të subjekteve që kanë dorëzuar deklaratat e pasurisë gjatë muajit janar 2017, por edhe nëse ajo pranon se ka refuzuar marrjen e dokumentacionit nga subjekti, ai vetë duhej të kujdesej duke këmbëngulur në zbatimin korrekt dhe të drejtë të ligjit.

82. Në lidhje me pretendimin e subjektit se gjetja e Komisionit për pasaktësi të deklaratës së rivlerësimit, për shkak se nuk është dorëzuar deklarata e pasurisë së personave të lidhur tek ILDKPKI-ja, bie ndesh me frymën e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ për vitin 2016”, datë 20.04.2017, e cila ka të bëjë me faktin se kur një rrethanë apo dokument është bërë prezent në një institucion shtetëror, bie pretendimi për mosparaqitje/fshehje, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi rezoluta e Kuvendit e sipërpërmendur lidhet me një proces krejt të ndryshëm nga ai i rivlerësimit dhe rezolutat e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së një institucioni lidhen ngushtësisht me objektin e tyre dhe nuk kanë karakter përgjithësues apo normativ.
83. Në lidhje me pretendimin e subjektit se ILDKPKI-ja, si institucioni i ngarkuar me ligj për kontrollin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të njoftonte subjektin për mungesën e dokumentacionit, sipas nenit 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se baza ligjore e cituar nga subjekti përcakton kompetencën e ILDKPKI-së në rastin e konstatimit të gabimeve materiale në deklarinimin periodik të pasurisë. Për deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës përcakton se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Ligji nr. 84/2016 në nenin 31, pikat 1 dhe 2 përcakton se subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së, e cila fillon menjëherë procedurën e kontrollit dhe i

dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas nenit 33 të këtij ligji. Për deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, e cila është deklarata e posaçme për vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë, kuadri ligjor për procesin e rivlerësimit nuk ka parashikuar kompetencën e ILDKPKI-së, që të njoftojë subjektin për korrigjime apo plotësime të saj. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, lidhur me këtë pasaktësi të subjektit ka kërkuar interpretim ligjor pranë ILDKPKI-së, e cila në përgjigjen e saj ka konstatuar përfundimisht se deklarimi i subjektit nuk është i saktë, në përputhje me ligjin. Subjekti pretendon se kjo përgjigje e ILDKPKI-së është dhënë në kundërshtim me nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative, për pasojë është i pavlefshëm. Trupi gjykues, lidhur me këtë pretendim të subjektit, vlerëson se bazuar në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, organet e tjera të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Komisioni ka kërkuar mendimin e ILDKPKI-së, në kuadrin e organit ndihmës, dhe përgjigja e këtij organi është në përputhje të plotë me kompetencën e tij të përcaktuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë nuk ka vend për pavlefshmëri.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

84. *Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit që subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë së personave të lidhur nuk qëndron, pasi vërehet lehtësisht se ekzistenca e llogarive bankare të fondeve të investimit të prindërve të subjektit, është konstatuar nga vetë ILDKPKI-ja; nuk rezulton të jenë konsumuar elementet objektive dhe subjektive të fshehjes së pasurisë sipas nenit 257/a/2 të Kodit Penal, as nga subjekti, as nga personat e lidhur me të, si dhe provohet me dokumentacion bankar se krijimi i fondit të investimit ka burim të ligjshëm, sikundër janë pagat e personave të lidhur. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën 2.900.000 lekë (për investimet në emër të prindërve) nuk qëndron, pasi ligji nr. 84/2016 nuk njeh “pamjaftueshmëri në mosdeklarim”. Gjatë gjithë hetimit, Komisioni i ka ngarkuar subjektin të rivlerësimit barrën e provës për situatën ligjore të “fshehjes së pasurisë”, ndërsa në vendim çuditërisht është argumentuar për fshehje pasurie, por është konkluduar për pamjaftueshmëri të mosdeklarimit të likuiditeteve. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit nuk është proces penal dhe vlerësimi i subjektit për secilin nga kriteret bëhet duke u bazuar në parimet e procedimit civilo-administrativ, prandaj në rastin konkret referimi i subjektit te normat penale është i gabuar.*

Trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se personat e lidhur, prindërit e subjektit janë investitorë në fondin e pensioneve “Raiffeisen Prestige”, investime të padeklaruara në deklaratën e rivlerësimit, për shkak të mungesës së deklaramit të tyre si persona të lidhur me subjektin. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektin të rivlerësimit barrën e provës për fshehje të pasurisë së personave të lidhur, për moszbatim të detyrimit ligjor për të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit pasuritë në emër të personave të lidhur, si dhe burimet e krijimit të tyre. Subjekti në shpjegimet e tij të datës 18.07.2018, ka argumentuar se burimi i krijimit të fondit të pensionit nga ana e prindërve, janë të ardhura të përfituara nga paga, pensionet, ekonomia ndihmëse në fshat dhe kursime ndër vite, fakt ky i reklamuar prej tyre pranë autoriteteve bankare. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në përfundim të procedurës së rivlerësimit, pasi ka dëgjuar edhe subjektin në seancë dëgjimore, në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, në faqen 33, në konkluzion është shprehur për deklarim të pamjaftueshëm lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën 2.900.000 lekë për investimet në emër të prindërve, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar kështu për deklarim të pasaktë dhe jo për fshehje pasurie, siç pretendon subjekti. Trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i

Komisionit është i drejtë, pasi deklarimi i pasaktë i subjektit për mosdeklarimin e likuiditeteve të prindërve të tij në shumën 2.900.000 lekë, vjen si pasojë e faktit se subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor për deklarimin e pasurisë së personave të lidhur sipas përbërjes së certifikatës familjare, rrethanë kjo e mjaftueshme për t'u mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, në drejtim të ngarkimit të subjektit me përgjegjësi disiplinore.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

85. *Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit se bashkëjetuesja e tij nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarim për vitet 2014 dhe 2015 nuk qëndron, pasi bashkëjetuesja ka nënshkruar rregullisht “Autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave”, por nga ana e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nuk është kërkuar për këtë periudhë “Kryerja e deklarimit me kërkesë”. Mungesa e reagimit të institucionit përgjegjës, ILDKPKI-së, i cili kishte detyrimin të kërkonte rregullsinë e plotësimit të deklaratës dhe anekseve të saj, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Qëndrimi interpretues i ILDKPKI-së, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision është një akt i pavlefshëm, pasi është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij, referuar nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative. Znj. A.O. nuk ka kryer asnjë veprim me qëllim tjetërsimin e pasurive të saj të paluajtshme, që nga momenti që i ka lindur detyrimi për deklarim, çka do të thotë se moshoqërimi i autorizimit me deklaratën e pasurisë nuk ka sjellë asnjë pasojë. Objekti i kontrollit nga institucionet e rivlerësimit duhet të ishte vetëm deklarata e pasurisë së rivlerësimit dhe jo deklaratimet e bëra në vite nga subjekti i rivlerësimit. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive nga znj. A.O. në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, është një pasaktësi e paqëllimshme. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se për vitet 2014, 2015, bashkëjetuesja e subjektit ka plotësuar vetëm faqen 8, “Autorizim”, të formularit të deklarimit periodik, duke evidentuar faktin që disponon pasuri veçmas, por nuk ka deklaruar pasuritë që disponon. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti bashkëlidhur shpjegimeve ka paraqitur një fletë, në të cilën ka nënshkruar vetëm me sigël një person për ILDKPKI-në më datë 31.03.2014 dhe për autoritetin përgjegjës të KLD-së ka nënshkruar Suela Zhegu, më datë 31.03.2014. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2014, të KLD-së, me lëndë “Njoftim mbi plotësime të gabuara në deklaratën e interesave privatë periodikë”, drejtuar z. Bledar Abdullahi. Me anë të kësaj shkrese, autoriteti përgjegjës në KLD njofton gjyqtarin Bledar Abdullahi se ILDKPKI-ja pas përfundimit të përpunimit paraprak të deklaratës periodike të pasurisë së tij, ka konstatuar mangësi në plotësimin e saj, pasi mungon autorizimi i bashkëshortes. Më tej, subjekti sqarohet se faqja 8 e autorizimit duhet të nënshkruhet nga bashkëshortja. Trupi gjykues vlerëson se në kundërshtim me sa pretendon subjekti, nga dokumentacioni i paraqitur prej vetë atij rezulton se ILDKPKI-ja ka reaguar në vitin 2014, duke evidentuar si shkelje mosdorëzimin e plotë të deklarimit të subjektit. Referimi i subjektit te neni 9 i ligjit nr. 9049, i ndryshuar, duke pretenduar se ILDKPKI-ja nuk i ka kërkuar bashkëjetueses të bëjë deklarim me kërkesë, është i gabuar. Bashkëjetuesja e subjektit, bazuar në nenin 21 të këtij ligji kishte detyrimin të plotësonte deklaratën “Autorizim” në të gjitha elementet përbërëse të saj, duke deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë.*

86. Në lidhje me pretendimin e subjektit se objekti i kontrollit nga institucionet e rivlerësimit duhet të ishte vetëm deklarata e pasurisë së rivlerësimit dhe jo deklaramet e bëra në vite nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 84/2016 në nenin 32, pika 5 parashikon se deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për verifikimin dhe vlerësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarameteve të subjektit në deklaratën e rivlerësimit krahasuar me deklaramet periodike, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete). Ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 3 ka përcaktuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti ka bërë deklaramet të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, sipas ligjit nr. 84/2016 pamjaftueshmëria e deklaramet për deklaramet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaramet të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaramet të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaramet të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Në këtë kontekst, rezulton se mosdeklaramet i plotë i znj. A.O. në vitet 2014 dhe 2015, nuk mund të shërbejë si konkluzion/shkak i veçuar mbi të cilin mund të mbështetet vendimi për shkarkimin e subjektit nga detyra, por ai duhet konsideruar në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.
87. Trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka kërkuar ILDKPKI-së interpretim ligjor në lidhje me mosdeklarametin e pasurisë nga znj. A.O. në vitet 2014 dhe 2015. Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.05.2018, ILDKPKI-ja ka argumentuar se bashkëjetuesja e subjektit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklaramet, për vitet 2014 dhe 2015, në përputhje me ligjin. Subjekti pretendon se ky vlerësim i dytë i ILDKPKI-së është i pavlefshëm, pasi vjen në kundërshtim me nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues arrin në të njëjtin konkluzion si në paragrafin 84 të këtij vendimi, duke e vlerësuar të pabazuar pretendimin e subjektit.
88. Trupi gjykues konstaton se znj. A.O., në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, që disponon pasuri veçmas, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive të saj. Subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në ankim, pretendon se ky fakt ka ndodhur në kushtet kur deklaramet i znj. A.O. në kuadër të ligjit nr. 84/2016, ka përkuar njëkohësisht dhe si deklaramet i saj fillestar në ILDKPKI. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimin kushtetues dhe ligjor sepse, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit D të Kushtetutës, nenet 30, 31, pika 1, 32, pika 1 dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit kanë detyrimin jo vetëm të deklarojnë pasuritë dhe burimin e

krijimit të tyre, por së bashku me deklaratën, të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Trupi gjykues vlerëson të theksojë se siç ka arsyetuar në paragrafët 37-38 të këtij vendimi, pavarësisht se mosdeklarimi i burimit është kryer nga bashkëjetuesja e subjektit, ligji nr. 84/2016 ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për pasaktësinë dhe pamjaftueshmërinë e deklaramit të personave të lidhur. Ligji nr. 84/2016 ka qenë i qartë në kërkesën për deklarimin e burimit të krijimit të pasurive dhe po kështu ka qenë edhe Udhëzimi datë 10.10.2016 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, për mënyrën e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Në këtë kuptim, për shkak të mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurive, i parë ky i lidhur edhe me rrethanën e mosdeklarimit të pasurive nga znj. A.O., në vitet 2014 dhe 2015, kur i kishte lindur detyrimi ligjor për deklarim, është i drejtë konkluzioni i Komisionit, se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

89. Trupi gjykues pasi analizoi çështjen në tërësi, pretendimet e subjektit të parashtruara në ankim, shpjegimet e paraqitura prej tij 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi dhe kërkesat e paraqitura nga subjekti bashkëlidhur tyre, si dhe provat e administruara nga Komisioni për këtë çështje, për kriterin e vlerësimit të pasurisë arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Bledar Abdullahi:
1. ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, pasi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për deklarimin saktësisht dhe plotësisht të pasurisë së personave të lidhur sipas certifikatës familjare (prindërve dhe vëllait), sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;
 2. ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, pasi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për deklarimin saktësisht dhe plotësisht të burimit të krijimit të pasurisë së personit të lidhur, bashkëjetueses së tij, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;
 3. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament, me sipërfaqe 66,60 m² dhe garazh, me adresë rruga “{***}”, Tiranë, në ish-pronësi të bashkëjetueses, znj. A.O., dhe të pasurisë apartament me sipërfaqe 98,3 m², në Golem, Durrës në pronësi të saj, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
90. Për këto arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
91. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

92. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Bledar Abdullahi gjendet në kushtet e nenit D, pikat 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Bledar Abdullahi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 20.06.2019.

ANËTAR

Ardian Hajdari
nënshkrimi

ANËTARE

Ina Rama
nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj
nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA
nënshkrimi

KRYESUES

Luan DACI
nënshkrimi